


1685/25
30-04-2025



Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d) dhe nenit 17 paragrafi 1 pika e) të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e RK-së" nr.28/2008), nenit 8 paragrafi 1 pika d) dhe nenit 13 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Graçanicës nr.6320/15 të datës 22.10.2015, Kuvendi i Komunës së Graçanicës në mbledhjen e katërt të rregullt, e mbajtur më datën 29.04.2025, merr këtë:

V E N D I M NR.23/2025/KG

për miratimin e Planit lokal të veprimit për cilësinë e ajrit 2025-2029

Neni 1

Miratohet Plani lokal i veprimit për cilësinë e ajrit për periudhën 2025-2029.

Neni 2


Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani lokal i veprimit për cilësinë e ajrit (Nr.1653/25 i datës 29.04.2025) për periudhën 2025-2029.

Neni 3

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi anulohet Vendimi nr.1061/25 (nr.13/2025/KG) të datës 25.03.2025 për miratimin e Planit lokal të veprimit për cilësinë e ajrit nr.1057/25 të datës 25.03.2025 për periudhën 2025/2029.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit të vendimit në ueb-faqen zyrtare të komunës.

Kryesuesi i Kuvendit

Milan Dimitrijević



1653/25 29-04-2025
Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit



PLANI LOKAL I VEPRIMIT PËR CILËSI TË AJRIT

2025-2029

Komuna e Graçanicës

2025

Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit



Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit 2025-2029

Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit

Parathënie



Të nderuar qytetarë,

Komuna e Graçanicës është e përkushtuar për ruajtjen e mjedisit, sepse në këtë mënyrë ne mbrojmë në mënyrë më të drejtpërdrejtë shëndetin dhe cilësinë e jetës së të gjithë qytetarëve, por edhe autenticitetin e mënyrës sonë të jetesës në harmoni me natyrën, duke i shfrytëzuar të mirat e saj pa abuzime ekologjike dhe shkatërrim.

Në planin e veprimit që keni para jush, mund të gjeni sfidat dhe kërcënimet kryesore për mjedisin tonë, sfidat e përcaktuara konkretisht në fushën e cilësisë së ajrit, si dhe mënyrat për tejkalimin e problemeve dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit në territorin e komunës së Graçanicës.

Cilësia e ajrit, si dhe stabiliteti ekologjik dhe qëndrueshmëria e mjedisit tonë, janë prioritet dhe bazë e zhvillimit tonë të qëndrueshëm.

Prof. Dr. Ljiljana Šubarić

Kryetar i Komunës së Graçanicës

Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit

Grupi Punues për Hartimin e Planit Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit

1. Dejan Mitić, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik
2. Slaviša Ničić, Drejtoria e Buxhetit dhe Financave
3. Miloš Artonović, Drejtoria e Inspekcioneve
4. Igor Rašić, Drejtoria e Planifikimit Hapësinor
5. Andjelka Jovanović, Drejtoria e Shërbimeve Publike

Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit

Tabela e përmbajtjes

Shkurtesa dhe akronime.....	9
1.0 HYRJE	14
2.0 PËRGJEGJËSITË DHE ZOTIMET	15
3.0 KORNIZA LIGJORE	15
4.0 METODOLOGJIA.....	16
5.0 KONSULTIMI	17
6.0 INFORMACION I PËRGJITHSHËM	17
6.1 Sektori bujqësor	20
6.2 Sektori i transportit	22
6.3 Përdorimi i tokës dhe mbulesa e tokës.....	23
6.4 Të dhëna meteorologjike	23
7.0 CILËSIA E AJRIT	25
7.1 Të dhëna nga monitorimi i cilësisë së ajrit.....	26
7.2 Të dhënat për emetimet në Graçanicë	33
7.2.1 Llogaritja e emetimeve.....	33
7.3 Përmbledhje e emetimeve në Komunën e Graçanicës.....	33
7.4 Emetimet nga burimet stacionare të banimit në Komunën e Graçanicës.....	39
7.5 Emetimet nga Industritë e Shërbimeve në Komunën e Graçanicës	44
7.6 Emetimet nga automjetet në Komunën e Graçanicës	45
7.7 Emetimet nga burime të tjera në Komunën e Graçanicës.....	46
8.0 PËRMBLEDHJE E MASAVE PËR KONTROLLIN E NDOTJES SË AJRIT NË KOMUNËN E GRAÇANICËS	47
9.0 OBJEKTIVAT DHE MASAT	48
9.1 Objektivat.....	48
Objektivi 1: Ulja e emetimeve nga burimet me djegie të vogël.	48
Objektivi 2: Ulja e emetimeve nga transporti.	48
Objektivi 3: Ulja e ndotjes së ajrit nga mbeturinat.....	48
Objektivi 4: Rritja e vetëdijesimit publik.	49
9.2 Masat	49
10.0 RENDITJA E PRIORITETEVE.....	50
11.0 VEPRIMET DHE INSTITUCIONET UDHËHEQËSE TË PLVCA-së.....	50
12.0 NDIKIMI I ZBATIMIT.....	50

Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit

13.0	VLERËSIMI I ZBATIMIT TË PLANIT TË VEPRIMIT	50
14.0	NDIKIMI I PRITUR I PLVCA-së	51
15.0	MONITORIMI DHE VLERËSIMI	51
15.1	Organi përgjegjës për kryerjen e monitorimit.	51
15.2	Periudha e monitorimit	52
16.0	KONKLuzion	52
17.0	TABELA E AKTIVITETEVE.....	56
	Objekti 1: Ulja e emetimeve nga burimet me djegie të vogël	56
	Objekti 2: Ulja e emetimeve nga sektori i transportit.....	58
	Objekti 3: Ulja e ndotjes së ajrit nga mbeturinat dhe sektori i ndërtimtarisë.....	59
	Objekti 4: Rritja e vetëdijesimit publik.....	60
ANEKSI 1		62
1.0	DËSHMI TEKNIKE PËR PLANIN LOKAL TË VEPRIMIT PËR CILËSI TË AJRIT	62
2.0.	Llogaritja për uljen e emetimeve	62
2.1.	Llogaritja për uljen e emetimeve nga djegia e vogël (banimi: burimet stacionare) në Komunën e Graçanicës	62
2.2	Llogaritja e uljes së emetimeve nga transporti (rrugor) në Komunën e Graçanicës	66
2.3.	Llogaritja e uljes së emetimeve nga subjektet e Lejes Mjedisore Komunale.....	69
2.4.	Llogaritja për uljen e emetimeve nga ndërtesat dhe objektet komunale.....	70
2.5.	Llogaritja për uljen e emetimeve nga industritë e shërbimeve.....	71
2.6.	Llogaritja për uljen e emetimeve nga menaxhimi i mbeturinave	72
2.7.	Llogaritja për uljen e emetimeve nga bujqësia	73

Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit

Tabela

Tabela 1- Trendet e popullsisë në Komunën e Graçanicës	18
Tabela 2- Numri i ndërmarrjeve për secilën kategori në komunën e Graçanicës.....	18
Tabela 3- Të dhënat për shfrytëzimin e tokës në sektorin e bujqësisë në komunën e Graçanicës	21
Tabela 4- Të dhëna për blegtorinë në komunën e Graçanicës	21
Tabela 5- Të dhëna për traktorët bujqësorë në komunën e Graçanicës.....	21
Tabela 6- Të dhënat për fuqinë punëtore për sektorin e bujqësisë në komunën e Graçanicës...	21
Tabela 7- Të dhënat nga regjistrimi i automjeteve në Graçanicë	22
Tabela 8- Moti në Prishtinë: ditë me reshje shiu dhe bore në vitet 2017-2021.....	24
Tabela 9- Standardi i Cilësisë së Ajrit.....	26
Tabela 10- Të dhënat për vlerën mesatare mujore të SO ₂ (µg/m ³) nga SMCA-të 2019-2022	27
Tabela 11- Të dhënat nga SMCA i IHMK-së për vlerën mesatare të NO ₂	29
Tabela 12- Të dhënat nga SMCA i IHMK-së për vlerën mesatare të PM ₁₀	30
Tabela 13- Të dhënat nga SMCA i IHMK-së për vlerën mesatare të PM _{2.5}	32
Tabela 14- Trendi i emetimeve të SO ₂ në Komunën e Graçanicë nga viti 2015 deri në vitin 2022	34
Tabela 15- Trendi i emetimeve të NO _x , Komuna e Graçanicës nga viti 2015 deri në vitin 2022 .	35
Tabela 16- Trendi i emetimeve të PM ₁₀ , Komuna e Graçanicës nga viti 2015 deri në vitin 2022	37
Tabela 17- Trendi i emetimeve të PM _{2.5} në Komunën e Graçanicë nga viti 2015 deri në vitin 2022.....	38
Tabela 18- Trendi i emetimeve të SO ₂ nga banimi: burimet stacionare në Komunën e Graçanicës	39
Tabela 19- Emetimet e SO ₂ nga shtëpitë e shkëputura sipas llojeve të derivateve në Komunën e Graçanicës	40
Tabela 20- Trendi i emetimeve të NO ₂ nga banimi: burimet stacionare në Komunën e Graçanicës	41
Tabela 21- Emetimet e NO ₂ nga shtëpitë e shkëputura sipas llojeve të derivateve në Komunën e Graçanicës	41
Tabela 22- Trendi i emetimeve të PM ₁₀ nga banimi: burimet stacionare në Komunën e Graçanicës.	42
Tabela 23- Emetimet e PM ₁₀ nga shtëpitë e shkëputura sipas llojeve të derivateve në Komunën e Graçanicës	42
Tabela 24- Trendi i emetimeve të PM _{2.5} nga banimi: burimet stacionare në Komunën e Graçanicës	43
Tabela 25- Emetimet e PM _{2.5} nga shtëpitë e shkëputura sipas llojeve të derivateve në Komunën e Graçanicës	43
Tabela 26- Trendi i emetimeve të SO ₂ nga Industritë e Shërbimeve në Komunën e Graçanicës	44
Tabela 27- Trendi i emetimeve të NO _x nga Industritë e Shërbimeve në Komunën e Graçanicës	44
Tabela 28- Trendi i emetimeve të PM ₁₀ nga Industritë e Shërbimeve në Komunën e Graçanicës	44
Tabela 29- Trendi i emetimeve të PM _{2.5} nga Industritë e Shërbimeve në Komunën e Graçanicës	45
Tabela 30- Emetimet nga automjetet në Komunën e Graçanicës në vitin 2022	45
Tabela 31- Emetimet e NO _x dhe PM ₁₀ nga Sektori i Bujqësisë në Komunën e Graçanicës	47

Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit

Tabela 1. Plani i veprimit për ndërrim të derivateve nga Dru / në Pelet/Energji Elektrike për burimet stacionare të banimit në Komunën e Graçanicës	62
Tabela 2. Plani i Veprimit për Kategorinë e Transportit Rrugor në Komunën e Graçanicës	66

Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit

Lista e figurave

Figura 1- Numri i ndërmarrjeve për secilën kategori në komunën e Graçanicës **Error! Bookmark not defined.**

Figura 2-Numri i automjeteve sipas tipit dhe numri i automjeteve sipas Rregullores Euro në Graçanicë.....	23
Figura 3 - Temperaturat dhe reshjet mesatare (Të dhënat historike të motit që nga viti 1940 për Graçanicën)	24
Figura 4- Të dhënat për vlerën mesatare mujore të SO ₂ 2019-2022.....	28
Figura 5- Të dhënat nga IHMK për vlerën mesatare të NO ₂	29
Figura 6- Të dhënat nga IHMK për vlerën mesatare të PM ₁₀	31
Figura 7- Të dhënat nga IHMK për vlerën mesatare të PM _{2.5}	32
Figura 8- Trendi i emetimeve të SO ₂ , Komuna e Graçanicës nga viti 2015 deri në vitin 2022....	34
Figura 9- Trendi i emetimeve të NO _x , Komuna e Graçanicës nga viti 2015 deri në vitin 2022....	36
Figura 10- Trendi i emetimeve të PM ₁₀ , Komuna e Graçanicës nga viti 2015 deri në vitin 2022.....	37
Figura 11- Trendi i emetimeve të PM _{2.5} , Komuna e Graçanicës nga viti 2015 deri në vitin 2022.....	39
Figura 12- Emetimet e SO ₂ nga shtëpitë e shkëputura sipas llojeve të derivateve në Komunën e Graçanicës	40
Figura 13- Emetimet e NO _x nga shtëpitë e shkëputura sipas llojeve të derivateve në Komunën e Graçanicës.....	41
Figura 14- Emetimet e PM ₁₀ nga shtëpitë e shkëputura sipas llojeve të derivateve në Komunën e Graçanicës	42
Figura 15- Emetimet e PM _{2.5} nga shtëpitë e shkëputura sipas llojeve të derivateve në Komunën e Graçanicës	43
Figura 16- Emetimet e NO _x dhe PM _{2.5} nga automjetet në Komunën e Graçanicës	46

Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit

Shkurtesa dhe akronime

AA	Agjencia për Akreditim
SAA	Spektrometri me Absorbim Atomik
BPYPTT	Bujqësi, Pylltari dhe Përdorim Tjetër i Tokës
UA	Udhëzim Administrativ
ICA	Indeksi i Cilësisë së Ajrit
SMCA	Stacioni i Monitorimit të Cilësisë së Ajrit
TMD	Teknologjia më e Mirë e Disponueshme
VK	Vlerësimi i Kapaciteteve
DK	Zhvillimi i Kapaciteteve
SMEV	Sistem për Monitorim të Emetimeve të Vazhdueshme
	Komiteti Evropian i Standardizimit
DKL	Dinamika komputacionale e lëngjeve
CO	Monoksid Karboni
DMMU (MMPHI)	Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave
KE	Komisioni Evropian
VKE	Vlerat Kufi të Emetimeve
Udhëzuesi EMEP/EEA	Programi Evropian i Monitorimit dhe Vlerësimit/Udhëzuesi i Agjencisë Evropiane të Mjedisit për Listën e Emetimeve të Ndotësve të Ajrit 2019
EEA	Agjencia Evropiane e Mjedisit
PES	Precipitues Elektrostatik
BE	Bashkimin Evropian
FC	Karboni i Fiksuar
SF	Studimi i Fizibilitetit
GS	Gaz Serrë
GIS	Sistemi i Informacionit Gjeografik

Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit

ARI	Automjet i Rëndë Industrial
PKIN	Parandalimi dhe Kontrolli i Integruar i Ndotjes (Ligji Nr.03/L-043)
PIPP	Proceset Industriale dhe Përdorimet e Produkteve
IPH (MMPHI)	Instituti për Planifikim Hapësinor
TI	Teknologjia e Informimit
JICA	Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar
AKK (MMPHI)	Agjencia Kadastrale e Kosovës
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
AMMK (MMPHI)	Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
IHMK (MMPHI)	Instituti Hidro-Meteorologjik i Kosovës
TC Kosova A	Termocentrali Kosova A
TC Kosova B	Termocentrali Kosova B
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
IMD	Impiant i Madh me Djegie
ALK	Automjet i Lehtë Komerical
VUN	Vlerë më e Ulët e Ngrohjes
GLN	Gaz i Lëngshëm i Naftës
MCC/MFK	Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit / Fondacioni i Mijëvjeçarit në Kosovë
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
ME	Ministria e Ekonomisë
MINT	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
TKE	Tavanet Kombëtare të Emetimeve (Direktiva për Tavanet Kombëtare të Emetimeve: DIREKTIVA (BE) 2016/2284 për uljen e emetimeve kombëtare të ndotësve atmosferikë të caktuar)
BOAJOM	Bashkëdyzime organike të avullueshme jo-metan

Plani Lokal i Veprimt për Cilësi të Ajrit

NO _x	Okside të azotit
NO ₂	Dyoksid azoti
O ₃	Ozoni
OM	Operimi dhe Mirëmbajtja
HAP	Hidrokarbure Aromatike Policiklike
PM ₁₀ , PM _{2.5} , PM ₁	Materie e grimcave me diametër prej 10µm ose më pak, 2.5µm ose më pak dhe 1.0µm ose më pak
MP	Makinë për Pasagjerë
PO	Plani i Operacioneve
SC	Sigurimi i Cilësisë
KC	Kontrolli i Cilësisë
PSA	Procesi i Stabilizim Asociimit
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
SIDA	Agjencia Suedeze për Bashkëpunim për Zhvillim Ndërkombëtar
OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
SO ₂	Dyoksid Squfuri
PSO	Procedura Standarde e Operimit
TC	Termocentral
GjGS	Gjithsej Grimca të Suspenduara

Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit (PLVCA) i Graçanicës përfshin një vlerësim gjithëpërfshirës të dokumenteve strategjike, politikave dhe planeve në lidhje me cilësinë e ajrit. Objektivi kryesor ishte formulimi i një grupi veprimesh të qarta, të fuqishme dhe me ndikim që do të çonin në përmirësime të prekshme në cilësinë e ajrit, do të përmirësonin shëndetin publik dhe do të mbështesnin rritjen e qëndrueshme ekonomike të qytetit tonë.

Synimet kryesore të këtij Plani të Veprimit janë përmirësimi i cilësisë së ajrit në të gjithë Graçanicën dhe futja e praktikave me emetim të ulët në institucionet tona, bizneset dhe stilin e jetës së qytetarëve deri në vitin 2029, në përputhje me kërkesat legjislative për cilësinë e ajrit. Qëllimi ynë është të adresojmë ndotësit më të rëndësishëm të ajrit në mënyrë gjithëpërfshirëse, me objektivin përfundimtar parandalimin e sëmundjeve dhe rritjen e mirëqenies së banorëve tanë.

Për të ruajtur dhe përmirësuar shëndetin publik përballë rritjes së popullsisë dhe zhvillimit të biznesit, është e domosdoshme të zbatohen një sërë veprimesh afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata. Këto veprime përfshijnë qasje të reja siç janë opsionet e ngrohjes shtëpiake dhe planifikimi i transportit.

Më pas, u identifikuan politikat dhe intervenimet bazuar në dëshmi dhe analiza, duke treguar se burimet kryesore të shqetësimit lokal të ndotjes së ajrit janë amvisëritë dhe sektori i transportit. Këto politika dhe intervenime kategorizohen në bazë të fushës së tyre dhe llojeve të efekteve që mund të arrijnë.

1. Zëvendësimi i derivatit në amvisëritë që përdorin dru dhe thëngjill me derivat më të pastër - Promovimi i ndërrimit të derivatit për të rritur eficiencën dhe qëndrueshmërinë në ngrohjen e amvisërive.

2. Rritja e eficiencës së energjisë – Promovimi i eficiencës së energjisë në sektorin e amvisërive për të përmirësuar jetën e qytetarëve dhe për të përmirësuar performancën e energjisë.

3. Ulja e ndotjes nga sektori i transportit – ka disa mundësi për të ulur emetimet që lidhen me lëvizjen e automjeteve në rrugë, duke përfshirë strategjitë dhe iniciativat ekzistuese që inkurajojnë mënyra të tjera transporti.

U zhvilluan punëtori konsultimi me palët kyçe të interesit, duke përfshirë autoritetet lokale, OJQ-të dhe organizatat e interesuara. Këto punëtori ofruan një mundësi për diskutim të hapur, duke mundësuar gjenerimin e ideve të reja dhe mbledhjen e reagimeve për masat e propozuara. Synimi ishte të sigurohej 'mbështetja' e duhur për veprimet e propozuara, duke siguruar që ato të mund të zbatohen në mënyrë efektive.

Plani i veprimit ja rrjedh si detyrim nga Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, i cili në nenin 28 kërkon Planin Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit, për periudhën pesëvjeçare. PLVCA-ja do të zhvillohet në përputhje me rolet dhe përgjegjësitë e Komunës.

Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit

Ky plan i veprimit është zhvilluar në përputhje me parimet e Programit të Qeverisë së Kosovës 2021-2025, duke marrë parasysh edhe dokumentet e tjera strategjike që do të zbatohen ose janë duke u zbatuar.

Tabela e veprimeve përmbledh veprimet që do të zbatohen midis viteve 2025 dhe 2029, për të përmirësuar cilësinë e ajrit. Kjo është vetëm përmbledhje; një version më i detajuar i tabelës me një thellësi më të madhe informacioni është përfshirë në seksionin përfundimtar të këtij dokumenti.

Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit

1.0 HYRJE

Emetimet ditore nga burime të ndryshme të ndotjes së ajrit kanë ndikim të rëndësishëm në cilësinë e ajrit. Këto burime përfshijnë objektet stacionare si fabrikat e prodhimit, makineritë me motorë me djegie të brendshme dhe djegien e drurit dhe thëngjillit. Për më tepër, burimet e lëvizshme si kamionët, autobusët, aeroplanët dhe makinat, si dhe burimet natyrore si pluhuri, kontribuojnë në ndotjen e ajrit.

Ndotësit e çliruar nga këto burime hyjnë në atmosferë, duke paraqitur kërcënime për shëndetin e njerëzve, kafshëve dhe ekosistemit më të gjerë. Cilësia e ajrit ndikohet nga disa faktorë, duke përfshirë sasinë e ndotësve të çliruar, shpejtësinë me të cilën ato shkarkohen në atmosferë dhe kohëzgjatjen për të cilën ato mbeten në një zonë të caktuar.

Të dhënat e vlerësuara nga Stacioni më i afërt për Monitorimin e Cilësisë së Ajrit (SMCA) dhe të dhënat statistikore të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) për Graçanicën, çojnë në përfundimin se ka ndotje të ajrit në këtë komunë. Ndotja në zonë shkaktohet kryesisht nga ngrohja e amvisërive (veçanërisht gjatë muajve të pikut të dimrit), automjetet dhe mbeturinat.

Sipas legjislacionit për cilësinë e ajrit, në rast të një përkeqësimi të papritur të cilësisë së ajrit, qytetet duhet të marrin masa për përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe mbrojtjen e banorëve. Cilësia e ajrit mund të përmirësohet duke ulur emetimet që ndikojnë në cilësinë e ajrit, duke ndikuar në shpërndarjen e ndotësve të ajrit, si dhe duke ulur ekspozimin e qytetarëve nëpërmjet një sërë metodash. Sipas legjislacionit për cilësinë e ajrit, Komuna është përgjegjëse për zhvillimin e Planeve Lokale për Cilësi të Ajrit për kontrollin e ndotjes së ajrit. Ky Plan Lokal për Ndotjen e Ajrit për periudhën 2025-2029 përmban hapa për të ulur ndotjen e ajrit të shkaktuar nga djegia e derivateve fosile, trafiku dhe pluhuri i rrugëve, si dhe mbetjet urbane dhe industriale.

Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh), në vitin 2019, vdekjet e parakohshme të lidhura me ndotjen e ajrit në natyrë kishin një ndikim të rëndësishëm në shëndetin publik. Përafërsisht 37% e këtyre vdekjeve të parakohshme u atribuohen sëmundjeve ishemike të zemrës dhe goditjes në tru, 18% ishin të lidhura me sëmundje pulmonare obstruktive kronike dhe 23% ishin të lidhura me infeksione akute të rrugëve të poshtme të frymëmarrjes. Për më tepër, 11% e këtyre vdekjeve i atribuoheshin kancerit të traktit respirator.

Në vitin 2019, 99% e popullsisë së botës jetonte në vende ku nuk përmbusheshin nivelet e udhëzimeve të OBSh-së për cilësinë e ajrit. Është e rëndësishme të theksohet se barra e ndotjes së ajrit të jashtëm bie në mënyrë disproporcionale mbi njerëzit në vendet me të hyra të ulëta dhe të mesme, me 89% të 4.2 milionë vdekjeve të parakohshme që ndodhin në këto rajone. Kjo statistikë e rëndë nënvizon se ndotja e ajrit është një nga kërcënimet më të rëndësishme mjedisore për shëndetin e njeriut.

Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit

Ulja e niveleve të ndotjes së ajrit mund të ketë një ndikim thelbësor në shëndetin publik duke zvogëluar barrën e sëmundjeve të tilla si goditja në tru, sëmundjet e zemrës, kanceri i mushkërive, si dhe sëmundjet kronike dhe akute të frymëmarrjes, përfshirë astmën.¹

Direktiva për Cilësinë e Ajrit të Ambientit 2008/50/EC tani po rishikohet, ndër të tjera për t'i përafëruar më mirë rregulloret e BE-së me udhëzimet e OBSH-së. Për shembull, për të mbrojtur shëndetin Organizata Botërore e Shëndetësisë tani rekomandon një prag maksimal prej 15 µg/m³ për grimcat e imëta (PM_{2.5}, ekspozim afatgjatë).²

Në Stacionin e Monitorimit të Cilësisë së Ajrit në IHMK mesatarja e PM₁₀ në vitin 2022 ishte 31.5µg/m³ dhe mesatarja e PM_{2.5} ishte 25.8µg/m³. Sipas standardeve të OBSH-së kjo paraqet ndotje të lartë. Në vitin 2022, mesatarja e PM₁₀ në Stacionin e Monitorimit të Cilësisë së Ajrit të IHMK-së ishte 31.5µg/m³, dhe mesatarja e PM_{2.5} ishte 25.8µg/m³. Sipas kriterëve të OBSH-së, kjo paraqet ndotje më të lartë.

Duke krijuar kornizën për cilësi më të mirë të ajrit, politika e Kosovës përpaket të dizajnojnë dhe zbatojë procedura të veçanta për të përmirësuar cilësinë e jetës në të gjitha zonat e vendit.

Bazuar në obligimet që rrjedhin nga Ligji Nr. 08/L-025 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, Komuna e Graçanicës vendosi të hartojë Planin e Veprimit Lokal për Cilësi të Ajrit në mënyrë që të përvijojë objektivat dhe masat që do të kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së ajrit, mbrojtjen e shëndetit dhe mjedisin e shëndetshëm.

2.0 PËRGJEGJËSITË DHE ZOTIMET

Ky PLVCA është përgatitur nga grupi punues i themeluar nga Komuna me mbështetjen e konsulentit kombëtar dhe ndërkombëtar, Zyrës së UNDP-së në Kosovë dhe Qeverisë së Luksemburgut. PLVCA-ja do t'i nënshtrohet një shqyrtimi dhe vlerësimi vjetor të progresit. Progresi i çdo viti do të raportohet në Raportin Vjetor të Mjedisit të përgatitur nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK), si pjesë e detyrave të saj statutores. Versioni më i fundit i PLVCA-së tonë do të jetë i disponueshëm në ueb faqen e komunës.

3.0 KORNIZA LIGJORE

Ligji Nr. 08/L-025 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja është miratuar nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2022.

¹ [https://www.who.int/news-room/fact-sheets/detail/ambient-\(outdoor\)-air-quality-and-health](https://www.who.int/news-room/fact-sheets/detail/ambient-(outdoor)-air-quality-and-health)

² <https://epha.org/the-who-air-quality-guidelines-should-be-used-to-set-air-pollution-reduction-targets-in-our-cities>

Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit

Ky ligj synon të rregullojë dhe sigurojë të drejtën e komuniteteve për të jetuar në një mjedis me ajër të pastër, duke mbrojtur shëndetin e njeriut, faunën, florën, dhe vlerat natyrore dhe kulturore të mjedisit, nga ndotja e ajrit. Gjithashtu kategorizon burimet kryesore të ndotjes dhe detyrimet për mbrojtjen e ajrit dhe rekomandon arritjen e vlerave kufitare të emetimeve (VKE) dhe normave të cilësisë së ajrit.

Udhëzimet Administrative (UA) që rrjedhin nga ligji janë:

- UA Nr. 02/2011 për normat e cilësisë së ajrit;
- UA (QRK) Nr. 07/2021 për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes;
- UA (QRK) 08/ 2016 për normat e lejuara të shkarkimeve në ajër nga burimet e lëvizshme të ndotjes;
- UDHËZIM ADMINISTRATIV(MMPHI) NR.16/2024 PËR VLERAT KUFITARE, VLERAT E SYNUARA, PRAGJET E ALARMIT PËR ARSENIN, KADMIUMIN, MERKURIN, NIKELIN DHE HIDROKARBURET AROMATIKE POLICIKLIKE NË AJËR;
- UDHËZIM ADMINISTRATIV MMPHI NR. 09/2023 PËR MËNYRËN E MONITORIMIT TË CILËSISË SË AJRIT, MBLEDHJEN E TË DHËNAVE, KRITERET DHE METODOLOGJINË;
- UA (QRK) Nr. 16/2013 për substancat që e dëmtojnë shtresën e ozonit dhe gazrat serrë të fluoruara.

4.0 METODOLOGJIA

Procesi i hartimit të këtij plani veprimi u strukturua që në fillim për të përfshirë palë të shumta të interesit, me një grup punues që përfshin një sërë agjencish, drejtues biznesi, ekspertë lokalë dhe OJQ mjedisore. Grupi Punues përcaktoi objektivat dhe synimet, duke kuptuar kontekstin lokal dhe ndikimin e cilësisë së ajrit në mirëqenien e qytetarëve.

Zyra e UNDP-së në Kosovë ka mbështetur grupin punues duke ofruar ekspertë lokalë dhe ndërkombëtarë, si dhe mbështetje financiare nga Qeveria e Luksemburgut.

Në zhvillimin e PLVCA-së u ndërmor një vlerësim i plotë për të analizuar sfidat kryesore të cilësisë së ajrit dhe për të identifikuar ndotësit kryesorë të ajrit që paraqesin shqetësimet më të mëdha në zonën e qytetit të Graçanicës. Bazuar në problematikat e identifikuara dhe ndotësit më shqetësues, ne kemi formuluar katër objektiva strategjike, të përzgjedhur për potencialin e tyre për të përmirësuar ndjeshëm cilësinë e ajrit në qytetin tonë. PLVCA-ja përshkruan masa specifike që do të luajnë një rol kryesor në përmirësimin e cilësisë së ajrit.

Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit

Për të garantuar llogaridhënie dhe transparencë, ne do të bëjmë një shqyrtim vjetor dhe do të raportojmë mbi progresin e bërë në zbatimin e planit të veprimit dhe adoptimin e masave të propozuara.

5.0 KONSULTIMI

Janë realizuar tri punëtori, takime, diskutime dhe konsultime me një grup punues të përbërë nga autoritetet komunale, përfaqësues nga institucionet qendrore, organizatat joqeveritare (OJQ) dhe bizneset.

Procesi i konsultimit filloi me prezantimin e draft PLVCA-së në një punëtori, publikimin e tij në ueb faqen e Komunës dhe shpërndarjen tek institucionet e tjera relevante, përfaqësuesit e të cilëve morën pjesë aktive në hartimin e planit. Gjithashtu, në përfundim të këtij procesi u mbajt një debat publik.

Secili aktivitet i përshkruar në PLVCA planifikohet, njihet dhe vlerësohet me kujdes përmes përpjekjeve bashkëpunuese me të gjitha palët e përfshira të interesit. Tabela e aktiviteteve ofron një pasqyrë të statusit të secilës masë, shqyrtimin dhe analizën e saj. Ky dokument u finalizua pas një analize të plotë të reagimeve dhe komenteve të dhëna nga palët e interesit.

6.0 INFORMATAT E PËRGJITHSHME

Komuna e Graçanicës gjendet në pjesën qendrore të Kosovës, dhjetë (10) kilometra në juglindje të Prishtinës, në rrugën kryesore Prishtinë – Gjilan. Territori i Komunës së Graçanicës mbulon një sipërfaqe prej 122.25 km². Lumi Graçanka, i cili buron nga poshtë digës së liqenit artificial të Badovcit, rrjedh përmes Graçanicës.

Meqenëse ndodhet në pjesën qendrore të Kosovës, kjo komunë me shekuj ka qenë nën ndikimin e qytetërimeve, kulturave dhe feve të ndryshme, të cilat lanë pas një histori të pasur dhe trashëgimi kulturore.

Komuna e Graçanicës shtrihet në skajin lindor të rrafshit të Kosovës, ku degët e Valetinit dhe degët pak më të pjerrëta të Stazhevcit bien në lumin Graçanka dhe në perëndim deri në lumin Sitnica.

Graçanica ndodhet në lartësinë 570 metra dhe është pjesë e një pellgu tektonik që ka zbritur përgjatë thyerjeve në mesin e periudhës terciare.

Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit

Graçanica lidhet me rruga kryesore me Serbinë Juglindore, dhe nëpër vendbanim kalojnë rrugë që të çojnë deri në Baltik dhe detin Adriatik dhe Shqipëri.³

Pozita e mirë, sa i përket largësisë nga kryeqyteti Prishtinë, ofron mundësi të mëdha për zhvillimin e Graçanicës, lokacion multikulturor, komercial dhe rezidencial.⁴

Popullata në komunën e Graçanicës paraqitet në **Error! Reference source not found.**⁵. Trendi i popullsisë është në rënie nga viti 2012 në 2020. Të dhënat e përgjithshme statistikore janë mbledhur dhe analizuar nga Baza e të dhënave të Agjencisë Statistike të Kosovës (<https://askdata.rks-gov.net/pxweb/en/ASKdata/>).

Tabela 1- Trendet e popullsisë në Komunën e Graçanicës

	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Graçanicë	11,197	11,359	11,720	11,900	11,997	12,091	12,124	12,186	12,229

Meqenëse komuna e Graçanicës është qytet i vogël, numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve nuk është aq i madh, por komuna e Graçanicës ka shumë lloje të aktiviteteve ekonomike. Aktualisht, shumica e aktiviteteve të biznesit në komunë janë biznese mikro dhe të vogla për tregti.⁶ "Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve, motoçikletave" përbëjnë numrin më madh të ndërmarrjeve, por numri nuk është i madh. Aktivitete të tjera ekonomike janë edhe një numër i vogël i shërbimeve dhe prodhimit.

Numri i ndërmarrjeve të regjistruara në Komunën e Graçanicës dhe sektori i aktivitetit ekonomik nga viti 2019 deri në vitin 2022 janë paraqitur në Tabela 2 dhe Figurën 1.

Tabela 2- Numri i ndërmarrjeve për secilën kategori në komunën e Graçanicës

Gjilan	A Bujqësi, pylltari dhe peshkim	B Mihje dhe gurorë	C Prodhimtari	D Furnizim me energji elektrike, gaz, avull dhe klimatizim	E Ujësjetës, ujëra të zeza, menaxhim i mbeturinave dhe sanim i tokës	F Ndërtimtari
2021						
2020	03	0	10	1	0	6
2019	0	0	7	0	0	5
2018	2	0	14	1	0	4
Gjilan	G	L	I	J	K	L

³ Plani Zhvillimor i Graçanicës 2014- 2029

⁴ Plani Zhvillimor i Graçanicës 2014- 2029

⁵ Burimi: Baza e të dhënave e ASK-së (<https://askdata.rks-gov.net/pxweb/en/ASKdata/>)

⁶ Plani Zhvillimor i Graçanicës 2014- 2029

Plani Lokal i Veprimt për Cilësi të Ajrit

	Tregti me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve, motoçikletave	Transport dhe deponim	Shërbime akomodimi dhe gastronomie	Informim dhe Komunikim	Aktivite financiare dhe të sigurimeve	Aktivite të pasurive të patundshme	
2021							
2020	19	6	18	2	0	0	
2019	35	1	12	1	1	1	
2018	31	5	15	1	2	2	
Gjilan	M Aktivite profesionale, shkencore dhe teknike	N Aktivite administrative dhe mbështetëse	O Administratë publike dhe mbrojtje, sigurimi i detyrueshëm shoqëror	P Arsim	Q Aktivite të shëndetit njerëzor dhe punës sociale	R Arte, zbavitje dhe rekreacion	S Aktivite të tjera të shërbimit
2021							
2020	5	2	0	0	4	0	4
2019	4	6	0	1	2	3	8
2018	6	1	0	0	1	2	4

Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit




Figura 1- Numri i ndërmarrjeve për secilën kategori në komunën e Graçanicës/Gračanica

6.1 Sektori bujqësor

Sipas Regjistrimit të Bujqësisë në Kosovë 2014, të dhënat e shfrytëzimit të tokës bujqësore në Graçanicë janë paraqitur në Tabelën 3. Aktiviteti bujqësor i komunës së Graçanicës është mjaft aktiv, sidomos ka një numër të madh të gjedhëve dhe derrave. Si rezultat, ka shumë traktorë për aktivitet bujqësor, megjithëse afërsisht 90% e traktorëve përdoren për më shumë se dhjetë vjet.

Plani Lokal i Veprimi për Cilësi të Ajrit

Tabela 3- Të dhënat për shfrytëzimin e tokës në sektorin e bujqësisë në komunën e Graçanicës

Perime - gjithsej		Plantacione me pemë - gjithsej			Numri i drunjve/shkurve - gjithsej		Kullota të përhershme		Gjithsej sipërfaqja e tokave nën shfrytëzim		Gjithsej sipërfaqja nën ujë	
Numri i pronave bujqësore	Sipërfaqe (ha)	Numri i pronave bujqësore	Sipërfaqe (ha)	Numri i drunjve, shkurreve në plantacione	Numri i pronave bujqësore	Numri i drunjve, shkurreve	Numri i pronave bujqësore	Sipërfaqe (ha)	Numri i pronave bujqësore	Sipërfaqe (ha)	Numri i pronave bujqësore	Sipërfaqe (ha)
Gracanica	245	15.83	162	25,604	2,933	64,209	267	616.48	1,756	615.66	82	77.71

Tabela 4- Të dhëna për blegtorinë në komunën e Graçanicës

Gjedhë			Buaj			Dhen			Dhi				
Numri i pronave bujqësore	Nr. i gjedhëve	Njësitë e masës së bagëtisë (NJMB)	Numri i pronave bujqësore	Nr. i buajve	Njësitë e masës së bagëtisë (NJMB)	Numri i pronave bujqësore	Nr. i dhenve	Njësitë e masës së bagëtisë (NJMB)	Numri i pronave bujqësore	Nr. i dhive	Njësitë e masës së bagëtisë (NJMB)		
234	908	657	0	0	0	19	851	85	70	266	27		
Derra			Kua, gomarë dhe mushka			Shpezë			Bagëti të tjera			Zgjoje bletësh	
Numri i pronave bujqësore	Nr. i derrave	Njësitë e masës së bagëtisë (NJMB)	Numri i pronave bujqësore	Nr. i kafshëve	Njësitë e masës së bagëtisë (NJMB)	Numri i pronave bujqësore	Nr. i shpezëve	Njësitë e masës së bagëtisë (NJMB)	Numri i pronave bujqësore	Nr. i kafshëve	Njësitë e masës së bagëtisë (NJMB)	Numri i pronave bujqësore	Nr. i zgjojeve të bletëve
906	5,631	1,267	8	10	8	1,054	39,090	999	18	176	4	59	1,375

Tabela 5- Të dhëna për traktorët bujqësorë në komunën e Graçanicës

Gjithsej numri i traktorëve		0 -10 vjet		Më shumë se 10 vjet	
Numri i pronave bujqësore	Numri i traktorëve në pronësi	Numri i pronave bujqësore	Numri i traktorëve në pronësi	Numri i pronave bujqësore	Numri i traktorëve në pronësi
850	963	68	69	807	894

Tabela 6- Të dhënat për fuqinë punëtore për sektorin e bujqësisë në komunën e Graçanicës

Fuqia punëtore - gjithsej		Posedues		Anëtarët e familjes së poseduesve		Të punësuar rregullisht në amvisëri bujqësore dhe biznese individuale		Të punësuar rregullisht në subjekte juridike bujqësore		Fuqi punëtore jo-familjare që punon në baza jo të rregullta (punëtorë sezonalë)		Fuqi punëtore jo e punësuar drejtpërdrejt nga fermat (punëtorë të kontraktuar)	
Punë bujqësore (NJVP)	Numri i personave	Punë bujqësore (NJVP)	Numri i personave	Punë bujqësore (NJVP)	Numri i personave	Punë bujqësore (NJVP)	Numri i personave	Punë bujqësore (NJVP)	Numri i personave	Punë bujqësore (NJVP)	Numri i personave	Punë bujqësore (NJVP)	Numri i personave
961	4,365	411	1,754	454	2,264	1	3	79	100	16	244		

Plani Lokal i Veprimt për Cilësi të Ajrit

6.2 Sektori i transportit

Komuna e Graçanicës përbëhet nga 16 (gjashtëmbëdhjetë) fshatave, shumica e të cilave janë të lidhura me rrugë lokale. Shumica e rrugëve brenda komunitetit kanë një profil të ulët. Rrugët e qasjes lokale.

Që nga themelimi i Komunës së Graçanicës, lagjet më të populluara janë rindërtuar dhe asfaltuar. Pjesa tjetër e rrugëve në zonat e banuara janë pjesërisht të asfaltuara. Sipërfaqja e përgjithshme e të gjitha rrugëve në komunën e Graçanicës është 2,696,301.00m².⁷

Tabela 7 dhe Figura 2 tregojnë të dhënat e regjistrimit të automjeteve në komunën e Graçanicës. Lloji kryesor i automjeteve janë makinat për pasagjerë (MP), dhe në vend të dytë janë automjetet e lehtë komerciale (ALK), dhe të tretë janë automjetet e rënda industriale (ARI).

Për shkak se përdorimi i automjeteve me regjistrim më pak se Euro 3 është më pak se 50% dhe i automjeteve me Euro 3 dhe 4 është më pak se 50%, situata me automjetet në komunën e Graçanicës është e ngjashme me komuna të tjera në Kosovë. Megjithatë, ende nënvizohet se emetimet nga veturat janë një nga burimet kryesore të ndotësve të ajrit në komunën e Graçanicës, përkundër faktit se përdorimi i automjeteve me Euro 5 dhe 6 nuk është shumë i lartë.⁸

Tabela 7- Të dhënat nga regjistrimi i automjeteve në Graçanicë

	EURO 0	EURO 1	EURO 2	EURO 3	EURO 4	EURO 5	EURO 6	Tjetër	Gjithsej
Autobusë	1	7	4	9	6	6	1	0	34
ARI (3.5t dhe mbi 3.5t)	12	3	47	106	115	107	22	6	418
ALK (nën 3.5t)	7	3	31	89	163	188	69	0	550
Kombibusë	1	1	1	4	4	1	0	0	12
Makina për Pasagjerë	318	125	289	827	782	566	484	0	3391
Tjetër	0	0	8	3	4	0	0	0	15
Gjithsej	339	139	380	1038	1074	868	576	6	4420

⁷ Plani Zhvillimor i Graçanicës 2014- 2029

⁸ Burimi: Të dhëna nga regjistrimi i automjeteve

Plani Lokal i Veprimt për Cilësi të Ajrit




Figura 1-Numri i automjeteve sipas tipit dhe numri i automjeteve sipas Rregullores Euro në Graçanicë

6.3 Përdorimi i tokës dhe mbulushmëria e tokës

Planifikimi i përdorimit të tokës ka potencialin për të përmirësuar ndjeshëm cilësinë e ajrit lokal. Planifikimi strategjik hapësinor mund të krijojë lidhje më të qëndrueshme transporti midis shtëpive dhe objekteve të zyrave, arsimit, shitjes me pakicë dhe kohës së lirë, si dhe të gjejë vende ideale për zgjerimin industrial potencialisht ndotës. Mund të ketë emetime të lidhura nga operacionet e transportit ose të djegies që sigurojnë nxehtësi dhe energji për një koncept specifik zhvillimi.⁹

Secili zhvillim i ri brenda një zone menaxhimi duhet të zhvillohet në përputhje me planin lokal të veprimt për cilësi të ajrit. Si rezultat, qeverisjet lokale duhet të zhvillojnë politika për të arritur cilësi të pranueshme të ajrit, si brenda ashtu edhe jashtë Zonave të Menaxhimit të Cilësisë së Ajrit, dhe t'i shqyrtojnë ato rregullisht për t'u siguruar që ato janë të përshtatshme dhe të përditësuara.

Në Komunën e Graçanicës nga gjithsej 7170506 m² tokë komunale, tashmë janë shfrytëzuar 1595591 m². Toka komunale e pashfrytëzuar është 5574915 m².

6.4 Të dhëna meteorologjike

Zona klimatike që përfshin Luginën e Ibrit është e ndikuar nga masat ajrore kontinentale. Si rezultat, dimrat në këtë vend janë dukshëm më të ftohtë, me temperatura mesatare nën - 10°C, por herë pas here arrijnë minus 26°C. Vera është mjaft e nxehtë, me një temperaturë mesatare prej 23°C dhe temperatura maksimale që herë pas here arrijnë deri

⁹ <https://www.iaqm.co.uk/text/guidance/air-quality-planning-guidance.pdf>

Plani Lokal i Veprimt për Cilësi të Ajrit

në 40°C. Është tipike që, përveç temperaturave të larta të ditës, netët janë relativisht të ftohta gjatë verës. Klima në këtë zonë është e thatë, me reshje totale vjetore prej rreth 600 mm për m².




Figura 2 - Temperaturat dhe reshjet mesatare (Të dhënat historike të motit që nga viti 1940 për Graçanicën)

“Maksimumi mesatar ditore” (vija e kuqe e plotë) tregon temperaturën maksimale të një dite mesatare për çdo muaj për Graçanicën. Po kështu, “minimumi mesatar ditore” (vija e kaltër e plotë) tregon temperaturën mesatare minimale. Ditët e nxehta dhe netët e ftohta (vijat e kuqe dhe të kaltra të ndërprera) tregojnë mesataren e ditës më të nxehtë dhe natës më të ftohtë të çdo muaji të 30 viteve të fundit. Shpejtësia e erës nuk shfaqet si parazgjedhje, por mund të aktivizohet në fund të grafikut.¹⁰

Të dhënat e vetme meteorologjike të publikuara për Kosovën janë për komunën fqinje të Prishtinës dhe janë paraqitur në tabelën 8¹¹.

Tabela 8- Moti në Prishtinë: ditë me reshje shiu dhe bore në vitet 2017-2021

Muaji	2017	2018	2019	2020	2021
-------	------	------	------	------	------

¹⁰ https://www.meteoblue.com/en/weather/historyclimate/climatemodelled/gra%C4%8Danica_kosovo_790265

¹¹ Burimi: <https://askdata.rks-gov.net/pxweb/en/ASKdata/>

Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit

	Ditë me shi dhe borë	Ditë me shi dhe borë	Ditë me shi dhe borë	Ditë me shi dhe borë	Ditë me shi dhe borë
janar	10	10	17	6	17
shkurt	6	18	6	10	7
mars	7	23	2	14	12
prill	10	6	19	8	14
maj	15	11	16	14	8
qershor	8	17	9	16	14
korrik	9	21	9	11	7
gusht	4	10	5	15	4
shtator	11	4	9	9	8
tetor	8	7	3	11	13
nëntor	14	10	16	2	9
dhjetor	12	13	14	12	13

7.0 CILËSIA E AJRIT

Kur ajri është i pastër, ai përfshin vetëm sasi të vogla të grimcave të ngurta dhe ndotësve kimikë. Cilësia e dobët e ajrit, me nivele të larta të ndotësve, është shpesh me mjegull dhe e rrezikshme për shëndetin dhe mjedisin. Indeksi i cilësisë së ajrit (AQI) përdoret për të përshkruar cilësinë e ajrit sepse bazohet në përqendrimin e ndotësve në ajër në një zonë të caktuar.

Llojet dhe nivelet e ndotësve në ajër kanë ndikim shumë më të lartë në cilësinë e ajrit. Megjithatë, faktorët gjeografikë si vargmalet dhe toka e modifikuar nga njeriu mund të shkaktojnë që ndotësit e ajrit të përqendrohen ose të shpërndahen në një vend të caktuar. Disa ndotës hyjnë në atmosferë për shkak të burimeve natyrore si aktiviteti vullkanik dhe stuhitë e pluhurit, por pjesa më e madhe krijohen nga aktiviteti njerëzor. Ndotja e ajrit e shkaktuar nga njeriu përfshin emetimin e emetimeve nga industritë, automjetet, termocentralet, amvisëritë, etj.

Ndotës të përgjithshëm janë monoksidi i karbonit, dyoksidi i squfurit, oksidi i azotit, dyoksidi i karbonit, ozoni, plumbi, grimcat (PM) dhe përbërësit sintetikë (p.sh. klorofluorokarburet (CFC)).

Studimi në terren dhe të dhënat e Stacionit të Monitorimit të Cilësisë së Ajrit (SMCA) tregojnë përqendrimet të konsiderueshme të PM₁₀ dhe PM_{2.5}, veçanërisht gjatë stinës së dimrit.

Plani Lokal i Veprimt për Cilësi të Ajrit

7.1 Të dhëna nga monitorimi i cilësisë së ajrit

Ligji Nr. 08/L-025 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja kërkon monitorimin e cilësisë së ajrit dhe trendet e rritjes apo uljes së cilësisë së ajrit. Meqenëse komuna e Graçanicës nuk ka SMCA, është përzgjedhur SMCA e IHMK-së sepse IHMK-ja është SMCA-ja më e afërt për komunën e Graçanicës.

Këto SMCA monitorojnë automatikisht një sërë ndotësish duke përfshirë dyoksidin e squfurit (SO₂), dyoksidin e azotit (NO₂), grimcat PM₁₀ dhe PM_{2.5}, siç detajohet në seksionin vijues.

Tabela 9 tregon Standardin e Cilësisë së Ajrit në Kosovë. Këto kërkesa janë përcaktuar në Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2011 për Normat e Cilësisë së Ajrit¹².

Tabela 9- Standardi i Cilësisë së Ajrit

Parametri	Vlerat kufi	Njësia e matjes	Vlerat kufi (µg/m ³)	Shkalla e tejkalimit të lejuar në vit
NO ₂	Vlera kufi për 1 orë për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m ³	200	18
	Vlera kufi vjetore për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m ³	40	Nuk është paraparë
	Vlera kufi vjetore për mbrojtjen e vegjetacionit	µg/m ³	30	Nuk është paraparë
SO ₂	Vlera kufi për 1 orë për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m ³	350	24
	Vlera kufi për 24 orë për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m ³	125	3
CO	Vlera kufi për mesataren ditore prej 8 orësh për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m ³	10	Nuk është paraparë
PM ₁₀	Vlera kufi për 24 orë për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m ³	50	35
	Vlera kufi vjetore për mbrojtjen e vegjetacionit	µg/m ³	40	Nuk është paraparë
PM _{2.5}	Vlera kufi vjetore për mbrojtjen e vegjetacionit	µg/m ³	25	Nuk është paraparë
O ₃	Objektivi afatgjatë për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m ³	120	Nuk është paraparë

¹² <https://ihmk-rks.net/?page=1,18>
<https://www.ammk-rks.net/al/mjedisi/20/raportet-mujore>

Plani Lokal i Veprimt për Cilësi të Ajrit

Pragu i informacionit	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	180	Nuk është paraparë
Pragu i alarmit	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	240	Nuk është paraparë

Të dhënat e monitorimit të cilësisë së ajrit nga SMCA janë mbledhur dhe analizuar nga Instituti Hidro-Meteorologjik i Kosovës (IHMK).¹³

Tabelat e mëposhtme paraqesin të dhënat mesatare vjetore të SMCA-së, të cilat krahasojnë të dhënat nga viti 2019 deri në vitin 2022. Ndotësit e përshkruar janë dyoksidi i squfurit (SO_2), dyoksidi i azotit (NO_2), grimcat PM_{10} , dhe grimcat $\text{PM}_{2.5}$.

Dyoksidi i squfurit (SO_2) SO_2 është komponenti më shqetësues dhe përdoret si tregues për grupin më të madh të oksideve të gaztë të squfurit (SO_x). SO_x të tjera të gazta (si SO_3) gjenden në atmosferë në përqendrime shumë më të ulëta se SO_2 . Burimet më të mëdha të emetimeve të SO_2 janë nga djegia e derivateve fosile në termocentrale, amvisëri dhe objekte të tjera industriale. Ekspozimet afatshkurtra ndaj SO_2 mund të dëmtojnë sistemin e frymëmarrjes së njeriut dhe të vështirësojnë frymëmarrjen. Në përqendrime të larta, SO_x i gaztë mund të dëmtojë pemët dhe bimët duke dëmtuar gjethet dhe duke zvogëluar rritjen.¹⁴

SO_2 dhe oksidet e tjera të squfurit mund të kontribuojnë në shiun acid, i cili mund të dëmtojë ekosistemet e ndjeshme.

Të dhënat për vlerat mesatare mujore të SO_2 prej SMCA-ve nga viti 2019 në 2022 janë paraqitur në Tabelën 10 dhe Figurën 4.

Tabela 10- Të dhënat për vlerën mesatare mujore të SO_2 ($\mu\text{g}/\text{m}^3$) nga SMCA-të 2019-2022

SO_2 ($\mu\text{g}/\text{m}^3$)	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Korr	Gu	Sht	Tet	Nën	Dhje
2019	6.2	3.1	3.2	2.7	3.7	6.6	8.0	7.4	8.1	11.2	6.8	11.1
2020	17.3	14.6				13.6	10.0	8.9	10.4	11.2	15.4	17.0
2021	13.6	11.2	9.1	5.8	9.2	12.0	18.4	15.4	3.5	2.2	2.8	3.1
2022	1.9	1.5	7.2	9.5	8.2	10.0	12.1	16.9	19.0	20.5	10.0	9.4

¹³ <https://ihmk-rks.net/?page=1,18>; <https://www.annmk-rks.net/al/mjedisi/20/raportet-mujore>

¹⁴ <https://www.epa.gov/so2-pollution/sulfur-dioxide-basics#>

Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit

[Prishtinë, IHMK] Vlera mesatare mujore e SO₂ (2019~2022)




Figura 3- Të dhënat për vlerën mesatare mujore të SO₂ 2019-2022

Mesataret mujore prej 125µg/m² janë mjaft të ulëta në krahasim me Standardin e Cilësisë së Ajrit për SO₂, gjë që tregon se masat e të ndotjes së ajrit nga kontrollit SO₂ nuk janë prioritet i lartë.

Dyoksidi i Azotit (NO₂)- NO₂ dhe NO_x të tjerë ndërveprojnë me ujin, oksigjenin dhe kimikatat e tjera në atmosferë për të formuar shiun acid. Shiu acid dëmton ekosistemet e ndjeshme si liqenet dhe pyjet. Grimcat e nitratit që rezultojnë nga NO_x e bëjnë ajrin të turbullt dhe mjegullues. Kjo ndikon në shumë parqe kombëtare dhe pyje. Ekspozimet më të gjata ndaj përqendrimeve të ngritura të NO₂ mund të kontribuojnë në zhvillimin e astmës dhe potencialisht të rrisin ndjeshmërinë ndaj infeksioneve të frymëmarrjes. Personat me astmë, si dhe fëmijët dhe të moshuarit janë përgjithësisht në risk më të madh nga efektet shëndetësore të NO₂. NO₂ së bashku me NO_x reagojnë me kimikate të tjera në ajër për të formuar grimcat dhe ozonin. Të dyja këto janë gjithashtu të dëmshme kur thithen për shkak të efekteve në sistemin e frymëmarrjes.¹⁵

Të dhënat për vlerat mesatare mujore të NO₂ prej SMCA-ve nga viti 2019 në 2022 janë paraqitur në Tabelën 11 dhe Figurën 5.

¹⁵ <https://www.epa.gov/so2-pollution/sulfur-dioxide-basics#>

Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit

Tabela 11- Të dhënat nga SMCA i IHMK-së për vlerën mesatare të NO₂

NO ₂ (µg/m ³)	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Korr	Gu	Sht	Tet	Nën	Dhje
2019	53.0	39.7	43.5	34.6	23.9	22.6	25.9	31.0	26.3	36.7	18.6	23.7
2020	32.6	28.1				17.0	13.6	17.7	17.7	25.0	26.1	20.5
2021	23.5	29.1	23.3	19.4	15.3	21.6	26.5	24.9	19.9	19.5	20.3	23.6
2022	35.9	33.3	36.3	22.8	27.0	24.9	26.9	29.3	19.6	29.2	21.7	16.4




Figura 4- Të dhënat nga IHMK për vlerën mesatare të NO₂

Kur krahasohet me Standardin e Cilësisë së Ajrit për NO₂, që është një mesatare vjetore, këto mesatare mujore shpesh nuk arrijnë 40 µg/m³, gjë që tregon se veprimet për të zbutur ndotjen e ajrit nga NO₂ nuk janë prioritet i lartë.

Materia grimcore (PM) - Ndotja e grimcave mund të vijë nga dy lloje të ndryshme burimesh - parësore ose dytësore. Burimet parësore shkaktojnë vetë ndotjen e grimcave. Për shembull, stufat me dru dhe zjarret në pyje janë burimet parësore. Burimet dytësore lëshojnë gazra që mund të formojnë grimca. Termocentralet dhe djegia e thëngjillit janë shembuj të burimeve dytësore. Disa burime të tjera të zakonshme të ndotjes së grimcave mund të jenë ose parësore ose dytësore - për shembull, fabrikat, makinat dhe kamionët

Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit

dhe vendpunishtet e ndërtimit. Ndotja e grimcave mund të prekë këdo, por ajo prek disa njerëz më shumë se të tjerët. Njerëzit që kanë më shumë gjasa të përjetojnë efekte shëndetësore të shkaktuara nga ndotja e grimcave përfshijnë ata me sëmundje të zemrës ose mushkërive (për shembull, astma), të moshuarit, foshnjat dhe fëmijët.¹⁶

Të dhënat për vlerat mesatare mujore të PM₁₀ prej SMCA-ve nga viti 2019 në 2022 janë paraqitur në Tabelën 12 dhe Figurën 6.

Tabela 12- Të dhënat nga SMCA i IHMK-së për vlerën mesatare të PM₁₀

PM ₁₀ (µg/m ³)	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Korr	Gu	Sht	Tet	Nën	Dhje
2019	64.3	45.3	37.6	27.9	12.5	18.3	16.0	19.4	18.5	38.0	23.3	33.6
2020	58.4	32.2				18.8	19.7	21.3	22.6	31.8	63.4	34.3
2021	30.1	51.5	32.7	24.4	18.9	24.3	22.5	21.4	21.5	25.6	34.1	25.8
2022	41.8	31.8	34.3	18.1	19.0	17.6	15.6	12.4	7.5	19.4	21.0	31.5

¹⁶ <https://deq.utah.gov/air-quality/particulate-matter-overview#:~:text=Particle>

Plani Lokal i Veprimt për Cilësi të Ajrit

[Prishtinë, IHMK] Vlera mesatare mujore e PM_{10} (2019~2022)




Figura 5- Të dhënat nga IHMK për vlerën mesatare të PM_{10}

Statistikat nga stacionet e monitorimit sugjerojnë një trend të përgjithshëm rënës mes viteve 2019 dhe 2022, me disa luhajtje gjatë stinës së verës dhe rritje gjatë stinës së dimrit. Shkaktarët kryesorë janë djegia e drurit dhe thëngjillit nga amvisëritë, por edhe pluhuri nga rrugët, ndërtesat dhe demolimet.

Kur krahasohet me vlerat e Standardit të Cilësisë së Ajrit për mesataren 24-orëshe të PM_{10} , mesataret mujore në dimër që arrijnë ose kalojnë $50\mu\text{g}/\text{m}^3$ tregojnë se janë me rëndësi veprimet për uljen e emetimeve të PM_{10} .

Materie grimcore ($PM_{2.5}$): Termi grimca të imëta, ose grimca 2.5 ($PM_{2.5}$), i referohet grimcave të vogla ose pikave në ajër që janë dy mikronë e gjysmë ose më pak në gjerësi. Emetimet nga djegia e benzinës, naftës, derivatit diesel ose drurit, prodhojnë pjesën më të madhe të ndotjes $PM_{2.5}$ që gjendet në ajrin e jashtëm, si dhe një pjesë të konsiderueshme të PM_{10} . Ka dëshmi të mjaftueshme që ekspozimi ndaj $PM_{2.5}$ për periudha të gjata (vite) mund të shkaktojë efekte të pafavorshme shëndetësore.¹⁷

¹⁷ chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcgiclfefindmkaj/https://www.4cleanair.org/wp-content/uploads/Oldmembers/members/committee/education/NYS-PMQ&A.pdf

Plani Lokal i Veprimet për Cilësi të Ajrit

Përqendrimet e PM_{2.5} janë shumë më të larta se limitet udhëzuese të OBSH-së (mesatarja vjetore prej 5 µg/m³ dhe mesatarja 24-orëshe prej 15 µg/m³), të cilat u përditësuan më 21 shtator 2021.

Të dhënat për vlerat mesatare mujore të PM_{2.5} prej SMCA-ve nga viti 2019 në 2022 janë paraqitur në Tabelën 13 dhe Figurën 7.

Tabela 13- Të dhënat nga SMCA i IHMK-së për vlerën mesatare të PM_{2.5}

PM _{2.5} (µg/m ³)	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Korr	Gu	Sht	Tet	Nën	Dhje
2019	57.8	33.2	24.0	16.7	8.2	10.9	9.5	10.2	11.0	22.6	16.9	27.0
2020	47.5	25.0				10.3	11.5	13.0	12.0	21.0	51.2	29.5
2021	25.7	38.3	24.0	16.1	9.1	14.0	13.6	11.4	11.3	18.2	27.9	21.7
2022	34.0	24.4	23.0	11.0	10.5	10.8	8.9	7.9	5.6	13.4	15.8	25.8

[Prishtinë, IHMK] Vlera mesatare mujore e PM_{2.5} (2019~2022)




Figura 6- Të dhënat nga IHMK për vlerën mesatare të PM_{2.5}

Mesatarja mujore nga tetori deri në prill është e tepërt kur krahasohet me vlerën e rekomanduar të OBSH-së prej 15µg/m³ për mesataren 24-orëshe të PM_{2.5}. Si rezultat, zbatimi i masave për uljen e emetimeve të PM_{2.5} është i rëndësishëm.

Plani Lokal i Veprimt për Cilësi të Ajrit

7.2 Të dhënat për emetimet në Graçanicë

7.2.1 Llogaritja e emetimeve

Emetimet është termi i përdorur për të përshkruar gazrat dhe grimcat që futen në ajër ose emetohen nga burime të ndryshme. Sasitë dhe llojet e emetimeve varen nga shumë faktorë, si sezoni, vendndodhja, aktiviteti ekonomik etj. Këto ndryshime shkaktohen nga ndryshimet në ekonominë e vendit, aktiviteti industrial, përmirësimet teknologjike, trafiku dhe nga shumë faktorë të tjerë. Rregulloret për ndotjen e ajrit dhe kontrollet e emetimeve kanë gjithashtu një efekt. Emetimet në ajër mund të vijnë nga një larmi burimesh dhe për këtë arsye zakonisht nuk grumbullohen në qendër përpara se të shkarkohen; prandaj, çdo burim ose kategori burimesh duhet të vlerësohet individualisht për të përcaktuar sasinë e lëshuar. Shpesh, emetimet në ajër ulen nga përdorimi i pajisjeve të kontrollit të ndotjes së ajrit dhe në llogaritjen e vlerësimit të emetimit duhet të merret parasysh efektiviteti i pajisjeve të kontrollit.¹⁸

Ligji Nr. 08/L-025 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja vuri në lëvizje një përpjekje mbarëkombëtare për përmirësimin e cilësisë së ajrit në vend. Që atëherë, janë hartuar udhëzime administrative shtesë për burime specifike të emetimeve. Sipas këtij ligji, AMMK është përgjegjëse për mbajtjen e një Inventarizimi të emetimeve në ajër i cili është pjesë e Sistemit Informativ Mjedisor.

Statistikat e emetimeve dhe llogaritjet e emetimeve për disa sektorë janë paraqitur më poshtë.

7.3 Përmbledhje e emetimeve në Komunën e Graçanicës

Emetimet e SO₂ në Komunën e Graçanicës janë paraqitur në Tabelën 14 dhe Figurën 8. "1. A.4 Djegia e vogël (tregtare / institucionale: burime stacionare)" prodhon më së shumti emetime SO₂. Kategoria e emetimeve të dyta më të mëdha të SO₂ është "A.4 Djegie e vogël (banimi: burime stacionare)." Emetimet e SO₂ nga kategoritë e tjera nuk janë aq të mëdha.

¹⁸ <https://www.sciencedirect.com/topics/engineering/air-emission>

Plani Lokal i Veprimt për Cilësi të Ajrit

Tabela 14- Trendi i emetimeve të SO₂ në Komunën e Graçanicë nga viti 2015 deri në vitin 2022

Sek/Kategoria	Njësia	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
1. Energji									
1.A Djegie									
1.1. Industritë e energjisë	SO ₂ ton/vit	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA
1.A.2 Industri prodhuese dhe ndërtimtari	SO ₂ ton/vit	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA
1.A.3 Transport	SO ₂ ton/vit	0.06	0.06	0.06	0.06	0.06	0.06	0.06	0.06
1.A.4 Djegie e vogël (tregtare / institucionale; stacionare)	SO ₂ ton/vit	41.02	44.67	25.53	32.36	34.19	27.81	27.81	27.81
1.A.4 Djegie e vogël (banimi; stacionare)	SO ₂ ton/vit	15.54	15.67	15.79	15.84	15.91	15.97	15.97	15.97
1.B Emetimet e ikura nga derivatet	SO ₂ ton/vit	NANN	NANN	NANN	NANN	NANN	NANN	NANN	NANN
2. Sektori i Proceeseve Industriale dhe Përdorimeve të Produktit	SO ₂ ton/vit	NANN	NANN	NANN	NANN	NANN	NANN	NANN	NANN
3. Bujqësi	SO ₂ ton/vit	0.01	0.01	0.01	0.01	0.01	0.01	0.01	0.01
5. Mbeturina	SO ₂ ton/vit	0.03	0.03	0.03	0.03	0.03	0.03	0.03	0.03
Gjithsej	SO ₂ ton/vit	56.67	60.45	41.42	48.30	50.19	43.88	43.88	43.88

Emetimet e SO₂ nga secili sektor në Graçanicë




Figura 7- Trendi i emetimeve të SO₂, Komuna e Graçanicës nga viti 2015 deri në vitin 2022

Emetimet e NO_x në Komunën e Graçanicës janë paraqitur në Tabelën 15 dhe Figurën 9. "1. A.3 Transporti" është kategoria me emetimet më të larta të NO_x. Kategoria "1. A.4

Plani Lokal i Veprimet për Cilësi të Ajrit

Djegje e vogël (banimi: burime stacionare)" është e dyta për emetime të NOx dhe Sektori i Bujqësisë është i treti. Emetimet e NOx nga "1. A.4 Djegje e vogël (tregtare/institucionale: burime stacionare)" janë gjithashtu jo të parëndësishme. Si rezultat, nëse kërkohen masa për kontroll të ndotjes së ajrit nga NOx, Komuna duhet të vlerësojë burime të shumta të emetimit të NOx

Tabela 15- Trendi i emetimeve të NOx, Komuna e Graçanicës nga viti 2015 deri në vitin 2022

Sek/Kategoria	Njësia	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
1. Energji									
1.A Djegje									
1.1. Industritë e energjisë	NOx ton/vit	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA
1.A.2 Industri prodhuese dhe ndërtimtari	NOx ton/vit	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA
1.A.3 Transport	NOx ton/vit	74.09	74.09	74.09	74.09	74.09	74.09	74.09	74.09
1.A.4 Djegje e vogël (tregtare / institucionale: stacionare)	NOx ton/vit	15.17	16.51	9.44	11.96	12.64	10.28	10.28	10.28
1.A.4 Djegje e vogël (banimi: stacionare)	NOx ton/vit	15.54	15.67	15.79	15.84	15.91	15.97	15.97	15.97
1.B Emetimet e ikura nga derivatet	NOx ton/vit	NANN	NANN	NANN	NANN	NANN	NANN	NANN	NANN
2. Sektori i Proceseve Industriale dhe Përdorimeve të Produktit	NOx ton/vit	NANN	NANN	NANN	NANN	NANN	NANN	NANN	NANN
3. Bujqësi	NOx ton/vit	13.63	12.73	11.53	10.34	10.39	10.56	10.56	10.56
5. Mbeturina	NOx ton/vit	0.02	0.02	0.02	0.02	0.02	0.02	0.02	0.02
Gjithsej	NOx ton/vit	118.45	119.03	110.87	112.26	113.05	110.93	110.93	110.93

Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit

Emetimet e NOx nga secili sektor në Graçanicë




Figura 8- Trendi i emetimeve të NOx, Komuna e Graçanicës nga viti 2015 deri në vitin 2022

Tabela 16 dhe Figura 10 tregojnë emetimet e PM₁₀ në komunën e Graçanicës. "1. A.4 Djegia e vogël (banimi: burime stacionare)" është kategoria me emetimet më të larta të PM₁₀. Emetimet nga sektori i bujqësisë nuk janë të parëndësishme, kurse nga kategoritë dhe sektorët e tjerë, si "1. A.4 Djegia e vogël (tregtare/institucionale: Burimet stacionare)" dhe "1. A.3 Transporti" janë të parëndësishme. Për shkak se burimi më i madh i emetimeve është shumë domethënës, "1. A.4 Djegia e vogël (banimi: burime stacionare)" është kategoria e parë prioritare për masa të kontrollit të ndotjes së ajrit nga PM₁₀.

Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit

Tabela 16- Trendi i emetimeve të PM₁₀, Komuna e Graçanicës nga viti 2015 deri në vitin 2022

Sek	Kategoria	Njësia	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
1.	Energji									
1.A	Djegje									
1.	Industritë e energjisë	PM10 ton/vit	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA
1.A.2	Industri prodhuese dhe ndërtimtari	PM10 ton/vit	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA
1.A.3	Transport	PM10 ton/vit	3.26	3.26	3.26	3.26	3.26	3.26	3.26	3.26
1.A.4	Djegje e vogël (tregtare / institucionale: stacionare)	PM10 ton/vit	6.61	7.19	4.11	5.21	5.51	4.48	4.48	4.48
1.A.4	Djegje e vogël (banimi: stacionare)	PM10 ton/vit	204.79	206.55	208.20	208.71	209.68	210.48	210.48	210.48
1.B	Emetimet e ikura nga derivatet	PM10 ton/vit	NANN	NANN	NANN	NANN	NANN	NANN	NANN	NANN
2.	Sektori i Proceseve Industriale dhe Përdorimeve të Produktit	PM10 ton/vit	NANN	NANN	NANN	NANN	NANN	NANN	NANN	NANN
3.	Bujqësi	PM10 ton/vit	10.71	10.97	10.97	10.87	10.92	11.10	11.10	11.10
5.	Mbeturina	PM10 ton/vit	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Gjithsej		PM10 ton/vit	225.36	227.97	226.54	228.05	229.36	229.31	229.31	229.31

Emetimet e PM10 nga secili sektor në Graçanicë




Figura 9- Trendi i emetimeve të PM₁₀, Komuna e Graçanicës nga viti 2015 deri në vitin 2022

Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit

Situata me PM_{2.5} është e njëjta si me PM₁₀. Tabela 17 dhe Figura 11 tregojnë emetimet e PM_{2.5} në komunën e Graçanicës. "1. A.4 Djegie e vogël (banimi: burime stacionare)" është kategoria me emetimet më të larta të PM_{2.5}. Kategoritë dhe sektorët tjerë, si kategoria "1. A.4 Djegie e vogël (tregtare/institucionale: stacionare)", kategoria "1. A.3 Transporti", dhe sektorin e bujqësisë, nuk janë aq të mëdhenj. Për shkak se burimi më i madh i emetimeve është shumë veçanërisht domethënës, "1. A.4 Djegie e vogël (banimi: burime stacionare)" është kategoria e parë prioritare për masa të kontrollit të ndotjes së ajrit nga PM_{2.5}.

Tabela 17- Trendi i emetimeve të PM_{2.5} në Komunën e Graçanicë nga viti 2015 deri në vitin 2022

Sek	Kategoria	Njësia	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
I.	Energji									
I.A	Djegje									
	1. Industritë e energjisë	PM _{2.5} ton/vit	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA
	1.A.2 Industri prodhuese dhe ndërtimtari	PM _{2.5} ton/vit	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA
	1.A.3 Transport	PM _{2.5} ton/vit	3.26	3.26	3.26	3.26	3.26	3.26	3.26	3.26
	1.A.4 Djegie e vogël (tregtare / institucionale: stacionare)	PM _{2.5} ton/vit	6.11	6.66	3.80	4.82	5.09	4.14	4.14	4.14
	1.A.4 Djegie e vogël (banimi: stacionare)	PM _{2.5} ton/vit	199.46	201.18	202.78	203.28	204.23	205.00	205.00	205.00
I.B	Emetimet e ikura nga derivatet	PM _{2.5} ton/vit	NANN	NANN	NANN	NANN	NANN	NANN	NANN	NANN
2.	Sektori i Proceseve Industriale dhe Përdorimeve të Produkte	PM _{2.5} ton/vit	NANN	NANN	NANN	NANN	NANN	NANN	NANN	NANN
3.	Bujqësi	PM _{2.5} ton/vit	0.84	0.87	0.86	0.84	0.84	0.86	0.86	0.86
5.	Mbeturina	PM _{2.5} ton/vit	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Gjithsej		PM _{2.5} ton/vit	209.67	211.96	210.70	212.21	213.42	213.26	213.26	213.26

Plani Lokal i Veprimt për Cilësi të Ajrit

Emetimet e PM_{2.5} nga secili sektor në Graçanicë




Figura 10- Trendi i emetimeve të PM_{2.5}, Komuna e Graçanicës nga viti 2015 deri në vitin 2022

7.4 Emetimet nga burimet stacionare të banimit në Komunën e Graçanicës

Trendi i emetimeve të SO₂ nga burimet stacionare të banimit në Komunën e Graçanicës paraqitet në Tabelën 18. Shtëpitë e shkëputura janë burimi parësor i emetimeve. Tabela 19 tregon emetimet nga shtëpitë e shkëputura sipas llojit të derivatit. Burimet parësore të emetimit të SO₂ janë druri dhe peleti. Figura 12. tregon trendin e emetimeve të SO₂ nga viti 2015 deri në 2020, si dhe raportin e emetimeve në vitin 2022 për shtëpitë e shkëputura.

Tabela 18- Trendi i emetimeve të SO₂ nga banimi: burimet stacionare në Komunën e Graçanicës

Njësia (SO ₂ ton/vit)	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
Shtëpi të shkëputura	8	8	8	8	8	8
Shtëpi gjysmë të shkëputura	1	1	1	1	1	1

Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit

Shtëpi në radhë ose tarraca (me 3 shtëpi të bashkuara ose të lidhura)	0	0	0	0	0	0
Ndërtesa ose blloqe banesore	0	0	0	0	0	0
Nëntotali banimi: Stacionare	9	9	9	9	9	9

Tabela 19- Emetimet e SO₂ nga shtëpitë e shkëputura sipas llojeve të derivateve në Komunën e Graçanicës

Njësia (SO ₂ ton/vit)	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
Thëngjill	4.25	4.25	4.25	4.34	4.34	4.34
GLN	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Benzinë	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Diesel	0.08	0.08	0.08	0.08	0.08	0.08
Dru	2.52	2.54	2.56	2.57	2.58	2.59
Peleta	1.08	1.09	1.10	1.11	1.11	1.12
Nëntotal - shtëpi të shkëputura	7.93	7.96	7.99	8.09	8.11	8.12




Figura 11- Emetimet e SO₂ nga shtëpitë e shkëputura sipas llojeve të derivateve në Komunën e Graçanicës

Tabela 20 paraqet trendin e emetimeve të NO_x nga burimet stacionare të banimit në Komunën e Graçanicës. Shtëpitë e shkëputura dhe gjysmë të shkëputura janë burimet parësore të emetimeve. Tabela 21 tregon emetimet nga shtëpitë e shkëputura sipas llojit të derivatit. Druri është burimi kryesor i emetimeve të NO_x. Figura 13 tregon trendin e emetimeve të NO_x nga viti 2015 deri në 2020, si dhe raportin e emetimeve në vitin 2022 për shtëpitë e shkëputura.

Plani Lokal i Veprimt për Cilësi të Ajrit

Tabela 20- Trendi i emetimeve të NO₂ nga banimi: burimet stacionare në Komunën e Graçanicës

Njësia (NO _x ton/vit)	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
Shtëpi të shkëputura	13	14	14	14	14	14
Shtëpi gjysmë të shkëputura	1	1	1	1	1	1
Shtëpi në radhë ose tarraca (me 3 shtëpi të bashkuara ose të lidhura)	0	0	0	0	0	0
Ndërtesa ose blloqe banesore	1	1	1	1	1	1
Nëntotali banimi: Stacionare	16	16	16	16	16	16

Tabela 21- Emetimet e NO₂ nga shtëpitë e shkëputura sipas llojeve të derivateve në Komunën e Graçanicës

Njësia (NO _x ton/vit)	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
Thëngjill	0.52	0.52	0.52	0.53	0.53	0.53
GLN	0.02	0.02	0.02	0.02	0.02	0.02
Benzinë	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Diesel	0.06	0.06	0.06	0.06	0.06	0.06
Dru	11.46	11.55	11.65	11.68	11.74	11.78
Pelet	1.38	1.39	1.41	1.41	1.42	1.42
Nëntotal - shtëpi të shkëputura	13.44	13.55	13.66	13.70	13.76	13.81




Figura 12- Emetimet e NO_x nga shtëpitë e shkëputura sipas llojeve të derivateve në Komunën e Graçanicës

Tabela 22 paraqet trendin e emetimeve të PM₁₀ nga burimet stacionare të banimit në Komunën e Graçanicës. Shtëpitë e shkëputura dhe gjysmë të shkëputura janë burimet parësore të emetimeve. Tabela 23 tregon emetimet nga shtëpitë e shkëputura sipas llojit të derivatit. Druri është burimi kryesor i emetimeve të PM₁₀. Figura 14 tregon trendin e

Plani Lokal i Veprimet për Cilësi të Ajrit

emetimeve të PM₁₀ nga viti 2015 deri në 2020, si dhe raportin e emetimeve në vitin 2022 për shtëpitë e shkëputura.

Tabela 22- Trendi i emetimeve të PM₁₀ nga banimi: burimet stacionare në Komunën e Graçanicës.

Njësia (PM ₁₀ ton/vit)	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
Shtëpi të shkëputura	177	179	180	181	182	182
Shtëpi gjysmë të shkëputura	17	17	17	17	17	17
Shtëpi në radhë ose tarraca (me 3 shtëpi të bashkuara ose të lidhura)	2	2	2	2	2	2
Ndërtesa ose blloqe banesore	9	9	9	9	9	9
Nëntotali banimi: Stacionare	205	207	208	209	210	210

Tabela 23- Emetimet e PM₁₀ nga shtëpitë e shkëputura sipas llojeve të derivateve në Komunën e Graçanicës

Njësia (PM ₁₀ ton/vit)	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
Thëngjill	1.91	1.91	1.91	1.95	1.95	1.95
GLN	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Benzinë	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Diesel	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Dru	174.14	175.62	177.10	177.50	178.39	179.08
Peleta	1.20	1.21	1.22	1.22	1.23	1.23
Nëntotal - shtëpi të shkëputura	177.25	178.74	180.23	180.67	181.56	182.26




Figura 13- Emetimet e PM₁₀ nga shtëpitë e shkëputura sipas llojeve të derivateve në Komunën e Graçanicës

Trendi i emetimeve të PM_{2.5} nga burimet stacionare të banimit në Komunën e Graçanicës paraqitet në Tabelën 24. Burimet kryesore të emetimeve janë shtëpitë e shkëputura dhe

Plani Lokal i Veprimt për Cilësi të Ajrit

shtëpitë gjysmë të shkëputura. Emetimet nga banimi janë paraqitur në Tabelën 25 sipas llojit të derivatit. Emetimet e PM_{2.5} shkaktohen kryesisht nga druri. Trajektorja në emetimet e PM_{2.5} nga viti 2015 në 2020 është paraqitur në Figurën 15, si edhe raporti i emetimeve në 2022 për shtëpitë e shkëputura.

Tabela 24- Trendi i emetimeve të PM_{2.5} nga banimi: burimet stacionare në Komunën e Graçanicës

Njësia (PM _{2.5} ton/vit)	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
Shtëpi të shkëputura	173	174	176	176	177	178
Shtëpi gjysmë të shkëputura	17	17	17	17	17	17
Shtëpi në radhë ose tarraca (me 3 shtëpi të bashkuara ose të lidhura)	2	2	2	2	2	2
Ndërtesa ose blloqe banesore	8	9	9	9	9	9
Nëntotali banimi: Stacionare	199	201	203	203	204	205

Tabela 25- Emetimet e PM_{2.5} nga shtëpitë e shkëputura sipas llojeve të derivateve në Komunën e Graçanicës

Njësia (PM _{2.5} ton/vit)	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
Thëngjill	1.88	1.88	1.88	1.92	1.92	1.92
GLN	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Benzinë	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Diesel	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Dru	169.56	171.00	172.44	172.83	173.69	174.36
Peleta	1.20	1.21	1.22	1.22	1.23	1.23
Nëntotal - shtëpi të shkëputura	172.63	174.09	175.54	175.97	176.84	177.52




Figura 14- Emetimet e PM_{2.5} nga shtëpitë e shkëputura sipas llojeve të derivateve në Komunën e Graçanicës

Plani Lokal i Veprimt për Cilësi të Ajrit

7.5 Emetimet nga Industritë e Shërbimeve në Komunën e Graçanicës

Tabelat 26 deri 29 tregojnë trendin e emetimeve nga Industria e Shërbimeve në Komunën e Graçanicës. Emetimet e SO₂ nga djegia e thëngjillit janë më të lartat. Emetimet e NO_x nga djegia e thëngjillit dhe djegia e gazit/naftës janë më të larta se emetimet nga llojet e tjera të derivateve. Emetimet nga djegia e thëngjillit janë më të lartat për PM₁₀ dhe PM_{2.5}.

Tabela 26- Trendi i emetimeve të SO₂ nga Industritë e Shërbimeve në Komunën e Graçanicës

Sektori	Kategori	Nënkategoria	Njësia	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
1. Energji											
1.A Djegie											
	1.A.4 Djegie e vogël										
		1.A.4.a.i Tregtare / institucionale: Stacionare	SO ₂ ton/vit	41.024	44.671	25.526	32.363	34.187	27.805	27.805	27.805
		Lignit	SO ₂ ton/vit	39.038	42.508	24.290	30.797	32.532	26.459	26.459	26.459
		Gaz natyror	SO ₂ ton/vit	0.004	0.005	0.003	0.003	0.004	0.003	0.003	0.003
		Benzinë	SO ₂ ton/vit	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000
		Naftë	SO ₂ ton/vit	1.480	1.611	0.921	1.168	1.233	1.003	1.003	1.003
		Vaj për djegie	SO ₂ ton/vit	0.412	0.449	0.256	0.325	0.343	0.279	0.279	0.279
		Dru Zjarri	SO ₂ ton/vit	0.054	0.059	0.034	0.043	0.045	0.037	0.037	0.037
		Pelet	SO ₂ ton/vit	0.036	0.039	0.022	0.028	0.030	0.024	0.024	0.024

Tabela 27- Trendi i emetimeve të NO_x nga Industritë e Shërbimeve në Komunën e Graçanicës

Sektori	Kategori	Nënkategoria	Njësia	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
1. Energji											
1.A Djegie											
	1.A.4 Djegie e vogël										
		1.A.4.a.i Tregtare / institucionale: Stacionare	NO _x ton/vit	15.166	16.514	9.437	11.964	12.638	10.279	10.279	10.279
		Lignit	NO _x ton/vit	8.040	8.755	5.003	6.343	6.700	5.449	5.449	5.449
		Gaz natyror	NO _x ton/vit	0.475	0.517	0.295	0.374	0.396	0.322	0.322	0.322
		Benzinë	NO _x ton/vit	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000
		Naftë	NO _x ton/vit	4.818	5.246	2.998	3.801	4.015	3.265	3.265	3.265
		Vaj për djegie	NO _x ton/vit	1.341	1.460	0.835	1.058	1.118	0.909	0.909	0.909
		Dru Zjarri	NO _x ton/vit	0.447	0.487	0.278	0.353	0.373	0.303	0.303	0.303
		Pelet	NO _x ton/vit	0.046	0.050	0.028	0.036	0.038	0.031	0.031	0.031

Tabela 28- Trendi i emetimeve të PM₁₀ nga Industritë e Shërbimeve në Komunën e Graçanicës

Sektori	Kategori	Nënkategoria	Njësia	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
1. Energji											
1.A Djegie											
	1.A.4 Djegie e vogël										
		1.A.4.a.i Tregtare / institucionale: Stacionare	PM ₁₀ ton/v	6.607	7.194	4.111	5.212	5.506	4.478	4.478	4.478
		Lignit	PM ₁₀ ton/v	5.438	5.921	3.383	4.290	4.531	3.685	3.685	3.685
		Gaz natyror	PM ₁₀ ton/v	0.005	0.005	0.003	0.004	0.004	0.003	0.003	0.003
		Benzinë	PM ₁₀ ton/v	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000
		Naftë	PM ₁₀ ton/v	0.331	0.360	0.206	0.261	0.276	0.224	0.224	0.224
		Vaj për djegie	PM ₁₀ ton/v	0.092	0.100	0.057	0.073	0.077	0.062	0.062	0.062
		Dru Zjarri	PM ₁₀ ton/v	0.703	0.765	0.437	0.554	0.586	0.476	0.476	0.476
		Pelet	PM ₁₀ ton/v	0.039	0.043	0.025	0.031	0.033	0.027	0.027	0.027

Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit

Tabela 29- Trendi i emetimeve të PM2.5 nga Industritë e Shërbimeve në Komunën e Graçanicës

Sektori	Kategori	Nënkategoria	Njësia	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
1. Energji											
1.A Djegie											
	1.A.4 Djegie e vogël										
	1.A.4.a.i Tregtare / institucionale:										
	Stacionare	PM2.5 ton/v		6.114	6.657	3.804	4.823	5.095	4.144	4.144	4.144
	Lignit	PM2.5 ton/v		5.019	5.465	3.123	3.960	4.183	3.402	3.402	3.402
	Gaz natyror	PM2.5 ton/v		0.005	0.005	0.003	0.004	0.004	0.003	0.003	0.003
	Benzinë	PM2.5 ton/v		0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000
	Naftë	PM2.5 ton/v		0.283	0.309	0.176	0.224	0.236	0.192	0.192	0.192
	Vaj për djegie	PM2.5 ton/v		0.079	0.086	0.049	0.062	0.066	0.054	0.054	0.054
	Dru Zjarri	PM2.5 ton/v		0.688	0.749	0.428	0.543	0.573	0.466	0.466	0.466
	Pelet	PM2.5 ton/v		0.039	0.043	0.025	0.031	0.033	0.027	0.027	0.027

7.6 Emetimet nga automjetet në Komunën e Graçanicës

Tabela 30 tregon emetimet e automjeteve në Komunën e Graçanicës në vitin 2022. Emetimet janë llogaritur duke shumëzuar numrin e automjeteve të regjistruar në Komunën e Graçanicës në vitin 2022, me faktorët e emetimit për secilën rregullore Euro. Agjencia e Regjistrimit Civil jep të dhënat për regjistrimin e automjeteve. Faktorët e emetimit janë marrë nga "1.A.3.b.i, 1.A.3.b.ii, 1.A.3.b.iii, 1.A.3.b.iv Makinat për pasagjerë, automjete të lehta komerciale, automjete të rënda industriale, duke përfshirë autobusë dhe motoçikleta" të "Udhëzuesit të EMEP/EEA për inventarin e emetimeve të ndotësve të ajrit 2019-Përditësimi i tetorit 2020"¹⁹. Parametri tjetër është "Kilometrazhi mesatar (km/veturë/vit)", nga Projekti i JICA për Zhvillimin e Kapaciteteve për Kontrollin e Ndotjes së Ajrit në Republikën e Kosovës²⁰.

Tabela 30- Emetimet nga automjetet në Komunën e Graçanicës në vitin 2022

	Emetimet e SO ₂	Emetimet e NO _x	Emetimet e PM ₁₀	Emetimet e PM _{2.5}
Viti 2022	kg SO2/vit	kg NOx/vit	kg PM10/vit	kg PM2.5/vit
Makina për Pasagjerë (diesel)	29.627	30,416.474	2,263.722	2,263.722
Makina për Pasagjerë (benzinë)	0.010	0.889	0.020	0.020
Kombibusë	0.136	179.887	15.132	15.132
ALK	6.235	7,973.497	296.378	296.378
ARI	21.794	29,140.229	500.778	500.778
Autobusë	1.901	6,372.316	181.448	181.448
Motoçikleta	0.010	7.335	0.095	0.095
Gjithsej	59.71	74,090.63	3,257.57	3,257.57

¹⁹ URL: <https://www.eea.europa.eu/publications/emep-eea-guidebook-2019/part-b-sectoral-guidance-chapters/1-energy/1-a-combustion/1-a-3-b-i/view>

²⁰ URL: <https://libopac.jica.go.jp/images/report/12363354.pdf>

Plani Lokal i Veprimt për Cilësi të Ajrit

Figura 16 tregon raportin e emetimeve të NOx sipas llojit të automjetit, që përbën emetimet më të mëdha ndër burimet e emetimeve, si dhe të emetimeve të PM_{2.5} sipas llojit të automjetit, i cili është bërë problem vitet e fundit.

Për sa i përket emetimeve të NOx, emetimet nga MP (makina për pasagjerë) janë më të lartat, të ndjekura nga emetimet nga ARI (automjete të rënda industrial). Janë shumë të larta emetimet e NOx nga MP-të me regjistrim nga Euro 2 në Euro 5. Kjo varet nga numri i MP-ve. Po ashtu, të mëdhenj dhe jo aq të ndryshëm janë edhe faktorët e emetimit NOx nga automjete para Euro 3, ndërsa as faktorët e emetimit të NOx nga Euro 4 dhe Euro 5 nuk janë aq të ndryshëm. Prandaj, për masat për NOx, ARI-të dhe MP-të me regjistrim të barabartë ose më pak se Euro 5, duhet të zëvendësohen me ARI dhe MP me regjistrim të barabartë ose më shumë se Euro 6.

Për sa i përket emetimeve të PM_{2.5}, është vendimtare rregullorja Euro. Meqenëse faktorët e emetimeve të PM_{2.5} nga MP-të me regjistrim të barabartë ose më shumë se Euro 6 janë krejtësisht më të vogla se kategoritë më të ulëta se Euro 6, zëvendësimi i MP-ve nën Euro 6 është shumë i rëndësishëm për masat e kontrollit të ndotjes së ajrit nga PM_{2.5} nga automjetet. Sidomos, duke qenë se është shumë i madh faktori i emetimeve të PM_{2.5} nga automjetet nën Euro 1, zëvendësimi i këtyre MP-ve është prioriteti i parë.




Figura 15- Emetimet e NOx dhe PM_{2.5} nga automjetet në Komunën e Graçanicës

7.7 Emetimet nga burime të tjera në Komunën e Graçanicës

Për sa i përket emetimeve të NOx nga sektori i bujqësisë, burimi më i madh i emetimeve është nënkategoria "Prodhimi i kulturave dhe toka bujqësore" e kategorisë "3.D Toka". Për

Plani Lokal i Veprimet për Cilësi të Ajrit

sa i përket emetimeve të PM₁₀ nga sektori i bujqësisë, burimet më të mëdha të emetimeve janë kategoria "3.B Blegtoria" dhe nënkategoria "Prodhimi i kulturave dhe toka bujqësore" e kategorisë "3.D Toka". Emetimet nga Sektori i Bujqësisë janë paraqitur në Tabelën 29.

Emetimet nga sektori i mbeturinave janë shumë të vogla.

Tabela 31- Emetimet e NO_x dhe PM₁₀ nga Sektori i Bujqësisë në Komunën e Graçanicës

Emetimet e NO _x nga Sektori i Bujqësisë në Komunën e Graçanicës											
Sektori	Kategoria	Nën kategoria	Njësia	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
3. Bujqësia											
	3.B Blegtoria		NO _x ton/v	2.07	2.06	2.03	1.96	1.98	2.15	2.15	2.15
	3.D Toka		NO _x ton/vit								
	Prodhimi i kulturave dhe toka bujqësore		NO _x ton/v	11.51	10.62	9.45	8.34	8.36	8.37	8.37	8.37
	3.D.f, 3.I Emetimet nga sektori i Bujqësisë dhe pesëiticideve		NO _x ton/v	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO
3.F Sektori i mbeturinave bujqësore				NO _x ton/v	0.01	0.01	0.01	0.01	0.01	0.01	0.01
			NO _x ton/v	13.59	12.69	11.49	10.31	10.35	10.53	10.53	10.53
Emetimet e PM ₁₀ nga Sektori i Bujqësisë në Komunën e Graçanicës											
Sektori	Kategoria	Nën kategoria	Njësia	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
3. Bujqësia											
	3.B Blegtoria		PM ₁₀ ton	2.76	2.83	2.84	2.68	2.74	2.92	2.92	2.92
	3.D Toka		PM ₁₀ ton/vit								
	Prodhimi i kulturave dhe toka bujqësore		PM ₁₀ ton	7.80	7.82	8.02	8.07	8.07	8.07	8.07	8.07
	3.D.f, 3.I Emetimet nga sektori i Bujqësisë dhe pesëiticideve		PM ₁₀ ton	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO	JO
3.F Sektori i mbeturinave bujqësore				PM ₁₀ ton	0.12	0.12	0.12	0.11	0.11	0.11	0.11
			PM ₁₀ ton	10.68	10.77	10.98	10.87	10.92	11.10	11.10	11.10

8.0 PËRMBLEDHJE E MASAVE PËR KONTROLLIN E NDOTJES SË AJRIT NË KOMUNËN E GRAÇANICËS

Sa i përket cilësisë aktuale të ajrit në Komunën e Graçanicës, të dhënat e monitorimit të cilësisë së ajrit tregojnë se burimi kryesor i ndotjes së ajrit janë grimcat PM_{2.5} dhe PM₁₀, dhe përqendrimet e NO₂ gjithashtu nuk janë të parëndësishme.

Për më tepër, statistikat për emetimet në Graçanicë (pika 4.0) tregojnë se kategoria "1.A.4 Djegie e vogël (banimi: burimet stacionare)" është burimi kryesor i emetimeve të PM_{2.5} dhe PM₁₀, ku situata e emetimeve nuk ndryshon dukshëm ndërmjet PM_{2.5} dhe PM₁₀. Për sa i përket emetimeve të NO_x, kategoria "1.A.3 Transporti" është burimi më i madh i emetimeve.

Prandaj, për masat e kontrollit të ndotjes së ajrit vlerësohen uljet e emetimeve të NO_x dhe PM_{2.5}.

Në Aneksin I është paraqitur Llogaritja për uljen e emetimeve për kategori të veçanta.

Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit

9.0 OBJEKTIVAT DHE MASAT

9.1 Objektivat

Qëllimi i kontrollit të ndotjes së ajrit është parandalimi i ndikimeve negative që ai ka në të gjithë njerëzit, florën dhe faunën. Shumica e burimeve të ndotjes në Komunën e Graçanicës që emetojnë SO₂, NO_x, PM₁₀, PM_{2.5}, ndër të tjera, janë djegia e derivateve (për shembull, djegia e derivateve të ngurta për ngrohjen e ndërtesave, transporti rrugor, bujqësia, etj.).

Objektivi 1: Ulja e emetimeve nga burimet me djegie të vogël.

Në Komunën e Graçanicës një numër i madh i amvisërive urbane dhe rurale përdorin dru dhe thëngjill për ngrohje dhe gatim. Kalimi nga djegia e drurit në pelet druri për shtëpitë e shkëputura dhe gjysmë të shkëputura do të zvogëlojë ndotjen e ajrit veçanërisht nga grimcat PM₁₀ dhe PM_{2.5}.

OBSH-ja përcakton derivatet dhe teknologjitë që janë të pastra për shëndetin në pikën e përdorimit si panele solare, energji elektrike, biogaz, gaz i lëngshëm i naftës (GLN), gaz natyror, derivat alkooli, si dhe stufa me biomasë që përmbushin objektivat e emetimeve në Udhëzimet e OBSH-së.²¹

Pajisjet e reja më efikase të ngrohjes mund të përmirësojnë cilësinë e ajrit të brendshëm dhe të jashtëm. Përdorimi i derivateve më të pastra, instalimi i pajisjeve me efikasitet të energjisë dhe pastrimi i rregullt i oxhaqeve mund të ndihmojnë në uljen e emetimeve.

Objektivi 2: Ulja e emetimeve nga transporti.

Promovimi i diversitetit modal përmes nxitjes së përdorimit të transportit publik, çka do të ulë përdorimin e automjeteve private, dhe i transportit pa motor me emetime zero.

Objektivi 3: Ulja e ndotjes së ajrit nga mbeturinat.

Kontrollet e ndotjes së ajrit janë gjithashtu një komponent i domosdoshëm i trajtimit të drejtpërdrejtë të formave të ndryshme të mbetjeve. Qëllimi është trajtimi i mbetjeve për të ulur toksicitetin, ekspozimet në ajër dhe, në fund të fundit, për të eliminuar ose të paktën për të ulur risqet nga substancat e rrezikshme në mbetje.

Nëse ndotësit e ajrit janë të pranishëm në një vend me rrjedhje të mirë ajri, ata do të përzihen me ajrin dhe do të shpërndahen me shpejtësi. Kur faktorë të caktuar, si erërat e buta ose malet, parandalojnë transportimin e ndotësve larg nga një vend, ata priren të qëndrojnë në ajër. Kur ndodh kjo, përqendrimet e ndotësve mund të rriten me shpejtësi.

²¹ <https://www.who.int/news-room/fact-sheets/detail/household-air-pollution-and-health>

Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit

Ky plan veprimi do të ofrojë gjithashtu bazën për mënyrën se si do të trajtojmë zhvillimet e reja në të gjithë komunën, me qëllim minimizimin dhe zbutjen e pasojave negative të mbetjeve, veçanërisht mbetjeve industriale. Ky plan do të përfshijë edhe masat e infrastrukturës së gjelbër, duke theksuar lidhjet midis mjedisit të ndërtuar dhe vendeve të gjelbra në të gjithë qytetin.

Objektivi 4: Rritja e vetëdijesimit publik.

Është shumë e rëndësishme të rritet vetëdijesimi dhe njohuria në lidhje me ndikimet shëndetësore të cilësisë së dobët të ajrit të jashtëm dhe cilësisë së ajrit të brendshëm, dhe të edukohen individët se si të ulin ekspozimin e tyre në shtëpi dhe jashtë.

Komunikimi efektiv me komunitetin është thelbësor në këtë drejtim. Shpërndarja e informacionit në lidhje me ndotjen e ajrit dhe risqet shëndetësore të lidhura me të duhet të bëhet përmes kanaleve që arrijnë në mënyrë efektive popullatat më të cenueshme. Rritja e shpërndarjes së informacionit mbi risqet shëndetësore të shkaktuara nga ndotja e ajrit po bëhet një prioritet gjithnjë e më i rëndësishëm. Kjo mund të arrihet duke përdorur metoda të ndryshme komunikimi, duke përfshirë organizimin e forumeve, përdorimin e mediave vizuale dhe më shumë.

9.2 Masat

Fokusi kyç i PLVCA-së qëndron në zbatimin efikas të tij. Në raste të caktuara, në bashkëpunim me institucionet dhe organizatat e tjera, Komuna e Graçanicës është e përkushtuar që të gjitha aktivitetet e përcaktuara në këtë Plan të Veprimit t'i realizojë brenda afateve të përcaktuara kohore. Ky angazhim shtrihet në përafrimin e këtyre veprimeve me udhëzimet e përcaktuara nga Qeveria.

Megenëse masat e përshkruara në planin e veprimit zbatohen vazhdimisht nëpër sektorë të veçantë, rrugët e financimit nga Komuna do të mbeten të hapura edhe në rast të ndonjë rishikimi të planit të veprimit. Kjo siguron që përmirësimet në cilësinë e ajrit të jenë të qëndrueshme dhe të mirëmbajtura, me fondet në dispozicion si për zhvillimin ashtu edhe për zbatimin e këtyre masave.

Për të siguruar zbatimin efektiv të Planit të Veprimit të Graçanicës, do të përdoren disa praktika inovative. Këto përfshijnë iniciativa për të zbutur ndotjen nga ngrohja e amvisërive, trajtimin e pluhurit të ndërtimit nëpërmjet monitorimit dhe praktikave më të pastra të ndërtimit, rritjen e kapacitetit të personelit për të minimizuar dhe kontrolluar ndotjen e ajrit nga mbetjet, duke përfshirë uljen e djegies së hapur të mbeturinave. Këto praktika përfshijnë gjithashtu sigurimin e njohurive dhe mbështetjes teknike, monitorimin efektiv të aktiviteteve të shërbimit, promovimin e transportit publik të qëndrueshëm dhe me emetim zero, dhe zbatimin e masave për të ulur emetimet e pluhurit në rrugë. Zbatimi i këtyre praktikave inovative do të monitorohet dhe raportohet nga afër si pjesë e këtij plani veprimi.

Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit

10.0 RENDITJA E PRIORITETEVE

Kostot e aktiviteteve në këtë PLVCA ndryshojnë, gjë që ndikon në prioritizimin e tyre dhe rrjedhimisht në zbatimin e tyre brenda afatit kohor të specifikuar.

11.0 VEPRIMET DHE INSTITUCIONET UDHËHEQËSE TË PLVCA-së

Politikat e mira që përfshijnë procese të qarta për zbatimin, llogaridhënien dhe përmirësimin janë kritike për të sjellë ndryshime. Investimi në përpjekjet për të përmirësuar të dhënat për vendimmarrje do të rrisë angazhimin për përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe si rrjedhojë do të rrisë saktësinë dhe ndikimin e politikave për të zbutur ndotjen e ajrit.

Sigurimi që politikat të përcaktojnë se çfarë nënkupton zbatimi i suksesshëm, do të garantojë llogaridhënie për të prodhuar rezultate të prekshme, të cilat nga ana e tyre do të rrisin vetëdijësimin dhe sjellje dhe veprime më të mira. Për të shfrytëzuar këtë mundësi, duhet të prioritizohen sfidat rreth mbledhjes së të dhënave cilësore në kohë, si dhe përgjegjësitë e zbatimit.

12.0 NDIKIMI I ZBATIMIT

Në zhvillimin e një plani veprimi për cilësinë e ajrit, masat e vazhdueshme të përshkruara në planin përfundimtar do të përbëjnë përmbajtjen thelbësore. Megjithatë, është thelbësore të merret parasysh edhe situata më e gjerë e cilësisë së ajrit brenda zonës së Komunës dhe qasjet strategjike të nevojshme për të siguruar që Komuna të mbetet në pajtueshmëri me objektivat e cilësisë së ajrit dhe të vazhdojë t'i ulë emetimet.

13.0 VLERËSIMI I ZBATIMIT TË PLANIT TË VEPRIMIT

Plani i veprimit për cilësinë e ajrit ka një afat kohor të ngushtë për zbatimin e të gjitha veprimeve të specifikuara. Rrjedhimisht, duhet të bëhet koordinimi i burimeve komunale për të siguruar përfundimin e këtyre planeve. Është thelbësore të monitorohet ecuria e zhvillimit të veprimit, të regjistrohen arritjet e rëndësishme dhe të dokumentohen pengesat e hasura gjatë zbatimit të këtij Plani të Veprimit. Kjo paraqet një mundësi për t'u angazhuar me organizatat partnere, për të kontaktuar palët e interesit dhe për të marrë mbështetje për këtë iniciativë.

Vlerësimi i zbatimit të planit është i një rëndësie të madhe dhe është i integruar pa probleme në çdo aspekt të detyrës që është zbatuar. Kjo qasje ndihmon në përcaktimin e fushave të interesit, fushave të përmirësimit dhe fushave për vlerësim. Prandaj, rivlerësimi mund të kërkojë përfshirjen e sektorëve shtesë në ekzekutimin e veprimeve për të

Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit

mbledhur të dhëna më të përditësuara dhe më të besueshme nëse është e nevojshme për ta rafinuar këtë Plan Veprimi.

14.0 NDIKIMI I PRITUR I PLVCA-së

Me zbatimin e PLVCA-së shumë veprime mund të kenë efekte plotësuese për të përmirësuar vazhdimisht cilësinë e ajrit dhe për të arritur përfitime të jashtëzakonshme mjedisore dhe shëndetësore.

Zbatimi i masave të këtij plani veprimi kërkon një planifikim të përpiktë. Për të përcaktuar suksesin e veprimeve, duhet të plotësohen kriteret e mëposhtme:

- koordinimi, komunikimi dhe bashkëpunimi ndërmjet të gjitha palëve përgjegjëse të përfshira në zbatimin e veprimeve të caktuara.
- mbështetja politike, ndarja e buxhetit, shkathtësitë teknike dhe një proces shqyrtimi dhe përmirësimi.
- burime të mjaftueshme për zbatimin e planit për të siguruar që të plotësohet brenda afateve kohore të specifikuara.
- Marrë parasysh buxhetin e vogël të komunës, mbështetja eventuale nga donatorët është shumë e rëndësishme për realizimin e projekteve të caktuara.

15.0 MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Për të siguruar që Komuna t'i zbatojë masat brende planit të veprimit në kohën e përcaktuar në plan, Komuna pret që autoritetet përgjegjëse të paraqesin përditësime për progresin përmes procesit të monitorimit. Përditësimet nga autoritetet përgjegjëse duhet të listojnë masat brenda planit të veprimit dhe të përfshijnë afatet deri kur ato duhet të zbatohen dhe të japin një përditësim mbi progresin në aspektin e zbatimit (duke përfshirë momente historike ose ku masat janë përfunduar). Kur një masë e planit të veprimit nuk po arrin uljen e dëshiruar të ndotjes së ajrit, ose është vonuar, kjo duhet të hetohet nga autoriteti dhe të sigurohet një veprim korrigjues për të adresuar problemin.

15.1 Organi përgjegjës për kryerjen e monitorimit.

Kryetarja e Komunës së Graçanicës, si organ përgjegjës për monitorimin e zbatimit të veprimeve të këtij PLVCA-ja, duhet të caktojë një komision.

Ky komision duhet t'i ofrojë Kuvendit Komunal raportet e monitorimit për vitin paraprak deri në fund të marsit të çdo viti. Kuvendi Komunal përpilon një raport përmbledhës në bazë të raportit të dorëzuar nga ky komision, dhe do ta dorëzojë në MMPHI brenda datës 1 qershor të vitit monitorues.

Monitorimi duhet të marrë parasysh pikat e mëposhtme:

Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit

- Efektshmëria e aktiviteteve të specifikuara nga PLVCA-ja
- Përfitimet sociale, ekonomike, dhe mjedisore; dhe
- Progresi drejt objektivave të PLVCA-së.

15.2 Periudha e monitorimit

Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit në Graçanicë është planifikuar të zbatohet për pesë vjet (2025-2029). Zbatimi duhet të monitorohet rregullisht.

Raporti i parë i monitorimit duhet të përfundojë brenda datës 1 mars 2026. Të dhënat në raportin e monitorimit do të përdoren për përditësimin e planit të veprimit sipas nevojës dhe ky proces do të përsëritet vit pas viti.

16.0 KONKLuzion

Sipas studimit profesional, të paktën disa nga hapat më ambiciozë të planifikuar për përmirësimin e cilësisë së ajrit mund të mos përfundojnë në kohën e caktuar. Kjo është për shkak të aftësisë së komunës për të siguruar buxhetin e planifikuar për këtë plan dhe numrit të mundësive për mbështetje nga donatorët.

Bazuar në objektivat e parashtruara, Komuna e Graçanicës dhe akterët e tjerë mbështetës kanë paraqitur një sërë veprimesh për zbatim.

Fazat e identifikuar në këtë dokument pritet të fillojnë në vitin 2025, sepse disa nga aktivitetet apo projektet janë aktualisht në ekzekutim ose janë duke siguruar mjete, dhe disa projekte mund të realizohen me buxhetin e ndarë të komunës ose me mbështetjen e donatorëve.

Totali i pritur për zbatimin e PLVCA-së është **571,000,00 euro**.

TABELA E AKTIVITETEVE QË RRJEDHIN NGA OBJEKTIVAT

17.0 TABELA E AKTIVITETEVE

Veprimi	Treguesi	Institucioni përgjegjës	Institucion et mbështetëse	Harku kohor	Kostot dhe burimet financiare	Komente
Objektivi 1: Ulja e emetimeve nga burimet me djegie të vogël						
1.1. Krijimi i një studimi fizibiliteti për opsionet e ndërrimit të derivatit	Gjetja e opsionit më të përshtatshëm për kalimin në derivat më të pastër për ngrohje të amvisërive	Komuna e Graçanicës	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktura, Agjencia e Statistikave të Kosovës	2025 - 2026	7,000.00 euro Buxheti komunal Mbështetje e mundshme nga donator	Përcaktimi me saktësi i numrit të amvisërive që përdorin tëngjill dhe vajra të rënda dhe naftë dhe gjetja e zgjidhjes më optimale për zëvendësim.
1.2. Zbatimi i masave specifike mbështetëse dhe stimulimi i zëvendësimit të burimeve të energjisë në amvisëri individuale	Zëvendësimi i kaldajave ekzistuese me tëngjill, naftë dhe dru me kaldaja më efikase me pellet dhe energji elektrike, të cilat do të kontribuonin në uljen e ndotjes së ajrit në nivel lokal.	Komuna e Graçanicës	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktura, Ministria e Financave	2026 - 2029	150,000.00 euro Buxheti komunal Mbështetje e mundshme nga donator	Ky projekt është afatgjatë dhe mund të parashikohet për 10 vjetet e ardhshme. Rekomandohet për amvisëritë që nuk do të përfshihen në sistemin e ngrohjes së qytetit

Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit

	(Faza e parë, masa e parashikuar për 100 amvisëri) do të kemi një ulje të PM2.5 për 25.9 ton/vit).	Komuna e Graçanicës	Agjencia për EE	2025 - 2029	200,000.00 euro Buxheti komunal Mbështetje e mundshme nga donator	Ndërtesat e vjetra përgjithësisht nuk kanë materiale termoizoluese dhe si të tilla kërkojnë konsum më të madh të energjisë për ngrohje dhe ftohje dhe për këtë arsye ndotin më shumë ajrin.
1.3 Aplikimi i masave nga fusha e eficientës së energjisë (EE), të cilat duhet të çojnë në uljen e konsumit të energjisë	Izolimi i ndërtesave me materiale të standardit më të lartë, çka do të çonte në uljen e konsumit të energjisë dhe rrjedhimisht një ndikim pozitiv në ajër.					
1.4 Pyllezimi dhe gjelbërimi i sipërfaqeve përgjatë rrugëve dhe në zonat ku toka është e cilësishme më të ulët ose nuk është e qasshme për kultivim bujqësor.	Rritja e përqindjes së pyjeve dhe sipërfaqeve të gjelbra në territorin e Komunës së Graçanicës	Komuna e Graçanicës	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	2025 - 2029	20,000.00 euro Buxheti komunal Mbështetje e mundshme nga donator	Përmirësimi i kushteve mjedisore, ulja e aromave të këqija të shkaktuara nga derivatet dhe ulja e stresit mjedisor. Studimi konstatoi se vendosja e kujdesshme e barit, dredhës dhe bimëve të tjera në kanionet urbane, mund të zvogëlojë përqendrimet e NO2 në rrugë deri në 40 për qind dhe nivelet e PM për 60 për qind, shumë më tepër nga sa besohet më parë.

Plani Lokal i Veprimt për Cilësitë e Ajrit

						https://www.acs.org/content/acs/en/pressroom/presspac/2012/acs-presspac-august-29-2012/green-plants-reduce-pollution-on-city-streets-up-to-eight-times-more-than-previously-believed.html
1.5. Krijimi i një programi për mbledhjen e të dhënave që mbledh të dhëna nga operatorët që i nënshtrohen Lejeve Mjedisore Komunale, në lidhje me përdorimin e derivateve prej tyre.	Zhvillimi i bazës së të dhënave për sasi të derivateve të përdorura për veprimtarinë e operatorëve që i nënshtrohen Lejes Mjedisore Komunale.	Komuna e Graçanicës	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktura, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës	2025 - 2029 Proces në vazhdim/konstant	Pa kosto	Mbledhja e këtyre të dhënave do të mbështeste inventarin e ajrit, i cili është shumë i rëndësishëm për përcaktimin e politikave që ulin nivelin e ndotjes së ajrit në komunë.
Objektivi 2: Ulja e emetimeve nga sektori i transportit						
2.1. Ndërtimi i shtigjeve për biçikleta	Programi për përcaktimin e korsiave të veçanta të biçikletave në rrugët e qytetit	Komuna e Graçanicës	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktura, Ministria e Financave	2025 - 2028	30,000.00 euro Buxheti komunal Mbështetje e mundshme nga donator	Ky program do ta bëntë më të lehtë lëvizjen e çiklistëve dhe do të rriste numrin e njerëzve që do ta përdornin këtë mjet transporti në baza ditore.
2.2. Ndërtimi i bypass-it të komunikacionit rreth Graçanicës	Ulja e numrit të automjeteve (veçanërisht kamionëve të rëndë) që kalojnë tranzit	Komuna e Graçanicës	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe	2025 - 2028	30,000.00 euro Buxheti komunal	Rruga kryesore Prishtinë-Gjilan kalon në qendër të Graçanicës. Një numër i madh i automjeteve, veçanërisht

Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit

	në për vetë Graçanicë, gjë që do ta ulte në mënyrë drastike ndotjen.	Komuna e Graçanicës	Infrastruktura rës			kamionëve të rëndë, kalojnë çdo ditë nëpër Graçanicë.
2.3. Blerja e automjeteve zyrtare elektrike dhe hibrde për nevojat e komunës	Kanë blerë 2 makina	Komuna e Graçanicës		2025-2029	100,000.00 euro Buxheti komunal Mbështetje e mundshme nga donator	Komuna ka një plan për vitet në vijim, kur është fjala për blerjen e automjeteve të reja, do të zëvendësojë automjetet e reja që janë blerë.
Objektivi 3: Ulja e ndotjes së ajrit nga mbeturinat dhe sektori i ndërtimitarisë						
3.1. Përcaktimi masave për kontrollin e emetimeve në ndërtesat që janë u nënshtrohen Lejeve të Ndërtimit dhe Lejeve Mjedisore të Komunës etj.	Është rritur numri i inspektorëve dhe inspektimeve.	Komuna e Graçanicës	Inspektorati Komunal dhe në raste të veçanta Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktura rës	2025 - 2029	12,000.00 euro	Përfshirë/buxhetimin e hyrave për punësimin e inspektorëve dhe shpenzime të tjera për inspektim Informimi i operatorëve që kanë leje ndërtimi dhe leje mjedisore komunale për masat e kontrollit të emetimeve për arritjen e kushteve më të mira për mjedisin.
3.2. Studimi i përbashkët me Minierën e Kishnicës dhe NovobërdësNovo bërdë	Zvogëlimi i përhapjes së pluhurit nga deponia e mbeturinave në Graçanicë e cila përmban metale të rënda	Komuna e Graçanicës dhe kompania Trepça	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktura rës,	2025 - 2028	10,000.00 euro Buxheti komunal Ministria e Ekonomisë	Në periudhat e verës kur ka thatësira të mëdha, erërat ngrënë re të mëdha pluhuri mbi një pjesë të madhe të territorit të komunës së Graçanicës dhe ndikojnë

Plan i Lokal i Veprimit për Cilësitë e Ajrit

- Trepça për rehabilitimin e mbeturinave në Graçanicë		Ministria e Ekonomisë			shumë negativisht në cilësinë e ajrit.
3.3. Ndalmimi i djegies së hapur të mbeturinave (gomave, plastikës, etj.), bërlogut dhe mbeetjeve të tjera.	Veprime të vazhdueshme që do të ndihmonin në uljen e ndotjes së ajrit	Komuna e Graçanicës	2025 Veprime në vazhdim	Pa kosto	Inspektimet e rregullta nga inspektorët komunalë do të ndihmojnë në uljen e ndotjes së ajrit
Objektivi 4: Rritja e vetëdijesimit publik.					
4.1. Organizimi i seminareve, ligjëratave në shkollë për burimet e ndotjes së ajrit dhe ndikimin në shëndet dhe mjedis.	Janë organizuar punëtori dhe ligjërata	Komuna e Graçanicës	OJQ-të lokale	2025-2029	6,000.00 euro
					- Programi u ndihmon individëve dhe organizatave të kuptojnë se si veprimet vullnetare mund të ulin ndotjen e ajrit dhe të përmirësojnë shëndetin e tyre. Programi ofron një shumëllojshmëri mësimesh dhe burimesh për mësuesit. - Edukimi i vazhdueshëm.
4.2. Organizimi i aktiviteteve informative dhe edukative që synojnë konsumimin	Organizimi i katër punëtorive dhe përpilimi i broshurave mbi mjetet më efikase	Komuna e Graçanicës	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe	2024 - 2029	6,000.00 euro

Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit

racional të energjisë, përdorimin e derivateve me miqësore me mjedisin, rritjen e efikasitetit të energjisë dhe përdorimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë.	energjetike për prodhimin e energjisë elektrike	Infrastruktura			
GJITHSEJ: 571,000.00 euro					

ANEKSI 1

1.0 DËSHMI TEKNIKE PËR PLANIN LOKAL TË VEPRIMIT PËR CILËSI TË AJRIT

Qasja për analizimin e mundësive për përmirësimin e cilësisë së ajrit është paraqitur me dëshmi teknike, së bashku me planet e veprimit për sektorët e mëposhtëm të ndotësve: emetimet nga nënkategoria e burimeve stacionare të banimit (ndërrimi i derivatit për shtëpi të shkëputura; emetimet nga ata që i nënshtrohen Lejes Mjedisore Komunale; emetimet nga ndërtesat dhe objektet komunale; emetimet nga industritë e shërbimeve; emetimet nga menaxhimi i mbeturinave; ndërrimi i derivatit nga druri/thëngjilli në energji elektrike; përmirësimi i efijencës së energjisë në ndërtesat e banimit përmes izolimit termik); emetimet nga ndërtimet dhe demolimet; emetimet nga transporti rrugor. Kjo analizë përfshin komponentët vijues: Skenarin, Uljen e emetimeve, Kostot, Efektshmërinë e kostove, Metodën e zbatimit; dhe Çështjet.

2.0. Llogaritja për uljen e emetimeve

2.1. Llogaritja për uljen e emetimeve nga djegia e vogël (banimi: burimet stacionare) në Komunën e Graçanicës

Burimi më i madh i emetimeve në kategorinë “1.A.4 Djegie e vogël (banim: burime stacionare)” në Komunën e Graçanicës është përdorimi i drurit për ngrohje/gatim në shtëpi.

Prandaj, objektivi i masës së kontrollit të ndotjes së ajrit nga djegie e vogël (banimi: burimet stacionare) është ndërrimi i derivatit nga druri në pelet dhe energji elektrike. Përdorimi i peletit dhe energjisë elektrike për gatim dhe ngrohje është një aktivitet i zakonshëm në Kosovë. Sidoqoftë, nuk është aq e lehtë të kalohet nga Druri në Pelet ose Energji elektrike për shkak të çmimit. Kjo do të thotë se Qeveria duhet të mbështesë ndërrimin e derivateve nga qytetarët, dhe kjo bëhet një nga përmbytjet e Planit Lokal të Veprimit.

Përmbytja e planit të veprimit do të zhvillohet si më poshtë në Tabelën 1.

Tabela 1. Plani i veprimit për ndërrim të derivateve nga Dru / në Pelet/Energji Elektrike për burimet stacionare të banimit në Komunën e Graçanicës

Emri	Ndërrimi i derivatit nga dru dhe thëngjill në pelet dhe energji elektrike për djegie të vogël në burimet stacionare të banimit
------	--

Plani Lokal i Veprimt për Cilësi të Ajrit

Pasqyra	Vitet e targetuara janë viti 2025 dhe viti 2029. Caku për vitin 2025: Numri i amvisërve që përdorin Dru do të zvogëlohet përmes planit lokal të veprimt. Caku për vitin 2029: Numri i amvisërve që përdorin Dru dhe Thëngjill do të zvogëlohet përmes planit lokal të veprimt. Komuna duhet të ofrojë disa forma të mbështetjes si sistemi i subvencioneve apo kredive, disa fushata dhe monitorim.
Skenari	Caku për vitin 2025: Caku janë amvisëritë që përdorin Dru dhe numri i cakt është 200. 100 amvisëri do kryejnë ndërrimin e derivatit nga Dru në Pelet. 100 amvisëri do kryejnë ndërrimin e derivatit nga Dru në Energji Elektrike. Caku për vitin 2029: Caku janë amvisëritë që përdorin Dru dhe Thëngjill dhe numri i cakt është 430. Të 30 amvisëritë që përdorin Thëngjill do ta ndërrojnë derivatin nga Thëngjill në Pelet. 200 amvisëri do kryejnë ndërrimin e derivatit nga Dru në Pelet. 200 amvisëri do kryejnë ndërrimin e derivatit nga Dru në Energji Elektrike.
Ulja e emetimeve	Caku për vitin 2025 WOM (asnjë ndryshim): 215.9 (ton PM_{2.5}/vit) WEM (në rast të masave): 203.9 (ton PM_{2.5}/vit) Ulja e emetimeve PM_{2.5}: Afërsisht -12.0 (ton PM_{2.5}/vit). Caku viti 2029 WOM (asnjë ndryshim): 224.1 (ton PM_{2.5}/vit) WEM (në rast të masave): 198.2 (ton PM_{2.5}/vit)

Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit

	Ulja e emetimeve PM _{2.5} : Afërsisht -25.9 (ton PM _{2.5} /vit).
Skenari i kostove 1 (viti 2024)	<Para zbatimit të masave> 1) Kosto fillestare: 350 euro/amvisëri (stufë me dru, niveli i njëjtë i pajisjeve për pajisjet ekzistuese) 2) Kosto të funksionimit në vit: 300 euro/amvisëri (Kostoja mesatare e drurit) 3) Gjithsej kosto për 10 vjet: $350 + 300 \times 10 = 4,350$ euro/amvisëri <Pas zbatimit të masave> 1) Kosto fillestare: $1000 + 900 = 1900$ euro/amvisëri (1000 euro për kaldajë të re me pelet ose elektrike, 900 euro për boiler, gyp, radiator, e kështu me radhë) 2) Kosto të funksionimit në vit: 1800 euro/amvisëri (Kosto mesatare të peletit), Kosto të funksionimit në vit: 1200 euro/amvisëri (kosto mesatare të energjisë elektrike) 3) Gjithsej kosto për pelet për 10 vjet: $1900 + 1800 \times 10 = 19,900$ euro/amvisëri Gjithsej kosto për energji elektrike për 10 vjet: $1900 + 1200 \times 10 = 13,900$ euro/amvisëri <Rritja e kostove pas Masave> 19900 (Pelet) – 4350 (Dru) = 15550 euro/amvisëri për 10 vjet. 13900 (Energji Elektrike) – 4350 (Dru) = 9550 euro/amvisëri për 10 vjet. Nëse janë 100 amvisëri, për pelet, $15550 \times 100 = 1.5555$ mijë euro për 10 vjet (rritja e kostos totale) Nëse janë 100 amvisëri, për pelet, $9550 \times 100 = 0.955$ mijë euro për 10 vjet (rritja e kostos totale) Gjithsej është 2.51 milionë euro për 10 vjet.
Skenari i kostove 2 (viti 2028)	<Para zbatimit të masave> 1) Kosto fillestare: 350 euro/amvisëri (stufë me dru/thëngjill, niveli i njëjtë i pajisjeve për pajisjet ekzistuese) 2) Kosto të funksionimit në vit: 300 euro/amvisëri (Kosto mesatare për dru/thëngjill)

Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit

	3) Gjithsej kosto për 10 vjet: $350 + 300 \times 10 = 4,350$ euro/amvisëri <Pas zbatimit të masave> 1) Kosto fillestare: $1000 + 900 = 1900$ euro/amvisëri (1000 euro për kalidajë të re me pelet ose elektrike, 900 euro për boiler, gyp, radiator, e kështu me radhë) 2) Kosto të funksionimit në vit: 1800 euro/amvisëri (Kosto mesatare të peletit), Kosto të funksionimit në vit: 1200 euro/amvisëri (kosto mesatare të energjisë elektrike) 3) Gjithsej kosto për pelet për 10 vjet: $1900 + 1800 \times 10 = 19,900$ euro/amvisëri Gjithsej kosto për energji elektrike për 10 vjet: $1900 + 1200 \times 10 = 13,900$ euro/amvisëri <Rritja e kostove pas Masave> 19900 (Pelet) – 4350 (Dru/Thëngjill) = 15550 euro/amvisëri për 10 vjet. 13900 (Energji Elektrike) – 4350 (Dru) = 9550 euro/amvisëri për 10 vjet. Nëse janë 230 amvisëri, për pelet, $15550 \times 230 = 3.5765$ milionë euro për 10 vjet (rritja e kostos totale) Nëse janë 200 amvisëri, për pelet, $9550 \times 200 = 1.910$ milionë euro për 10 vjet (rritja e kostos totale) Gjithsej është 5.4865 milionë euro për 10 vjet.
Efektshmëria e kostove	Caku për vitin 2025: Kostot për uljen e emetimeve $PM_{2.5}$ janë afërsisht $20,917$ (euro/ton). Caku për vitin 2029: Kostot për uljen e emetimeve $PM_{2.5}$ janë afërsisht $21,184$ (euro/ton).
Metoda e zbatimit	Fushata/aktivitete vetëdijësimi do të zhvillohen nga Komuna. Do të zhvillohet një fushatë kreditimi për amvisëritë me të hyra të mesme, komuna në bashkëpunim me bankat komerciale do ta mbështesë këtë tranzicion. Subvencionet për personat me të hyra të ulëta do të kryhen përmes Komunës. MF-ja do ta lehtësojë vendosjen e uljes së tatimeve.

Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit

Çështjet	Si të vendoset mbështetja e kostove të funksionimit nga komuna dhe/ose Ministria për amvisëritë me status të ulët socio-ekonomik. Çmimi aktual i energjisë elektrike është shumë i shtrenjtë. Është shumë e vështirë të parashikohet statusi për të ardhmen e afërt. Konsumi vjetor i drurit prej rreth 11 m³/amvisëri është afërsisht i njëjtë me 36 MWh/amvisëri si konsum vjetor i energjisë elektrike. Nëse 10,000 shtëpi (afërsisht 5% e shtëpive të shkëputura) që përdorin dru në Kosovë, do të kalonin nga Druri në Energji Elektrike, Kosova do të kërkonte konsum shtesë të energjisë elektrike prej përafërsisht 360 GWh/vit. Kjo vlerë është afërsisht 6% rritje e konsumit vjetor të energjisë elektrike në Kosovë. Veç kësaj, nëse secila amvisëri me ndërrim të derivatit nga Druri në Energji Elektrike ka nevojë për 10 kW kapacitet shtesë përçues të energjisë elektrike, Kosova do të kërkonte 100 MW kapacitet shtesë të energjisë elektrike. Edhe pse këto janë vlerësime shumë të përafërta, ky kapacitet shtesë i energjisë elektrike është shumë i vështirë për Kosovën në situatën aktuale.
----------	---

2.2 Llogaritja e uljes së emetimeve nga transporti (rrugor) në Komunën e Graçanicës

Makinat me rregullore të vjetër Euro janë burimi më i madh i emetimeve në kategorinë “Transport 1.3” në Komunën e Graçanicës.

Përmbajtja e planit të veprimit do të zhvillohet si më poshtë Tabela 2.

Tabela 2. Plani i Veprimit për Kategorinë e Transportit Rrugor në Komunën e Graçanicës

Emri	Ulja e përdorimit të automjeteve me rregullore të vjetër Euro
Pasqyra	Vitet e targetuara janë viti 2025 dhe viti 2029. Caku për vitin 2025: Do të ndërpritet përdorimi i automjeteve me rregullore të barabartë dhe më të vogël se Euro 1. Këto automjete do të zëvendësohen me automjete me Euro 4.

Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit

	Caku për vitin 2029: Do të ndërpritet përdorimi i automjeteve me rregullore të barabartë dhe më të vogël se Euro 3. Këto automjete do të zëvendësohen me automjete me Euro 4. Llojet e automjeteve të targetuara janë makina për pasagjerë (MP), kombibusë, automjete të lehta komerciale (ALK), automjete të rënda industriale (ARI) dhe autobusë.								
Skenari	Viti i targetuar 2025: numri i mëposhtëm i automjeteve do të zëvendësohet me automjete me Euro 4. Numri i MP-ve me rregullore Euro 0 dhe 1: 318 dhe 125 Numri i Kombibusëve me rregullore Euro 0 dhe 1: 1 dhe 1 Numri i ALK-ve me rregullore Euro 0 dhe 1: 7 dhe 3 Numri i ARI-ve me rregullore Euro 0 dhe 1: 12 dhe 3 Numri i autobusëve me rregullore Euro 0 dhe 1: 1 dhe 7. Caku për vitin 2029: (përfshirë masat për vitin 2024) numri i mëposhtëm i automjeteve do të zëvendësohet me automjete me Euro 4. Numri i MP-ve me rregullore Euro 2 dhe 3: 289 dhe 827 Numri i Kombibusëve me rregullore Euro 2 dhe 3: 1 dhe 4 Numri i ALK-ve me rregullore Euro 2 dhe 3: 31 dhe 89 Numri i ARI-ve me rregullore Euro 2 dhe 3: 47 dhe 106 Numri i autobusëve me rregullore Euro 2 dhe 3: 4 dhe 9.								
Ulja e emetimeve	Ulja e emetimeve NO_x (ton NO_x/vit) <table><tr><td></td><td>Viti aktual</td><td>Viti 2024</td><td>Viti 2028</td></tr><tr><td></td><td></td><td></td><td></td></tr></table>		Viti aktual	Viti 2024	Viti 2028				
	Viti aktual	Viti 2024	Viti 2028						

Plani Lokal i Veprimit për Cilësitë Ajrit

Makina për Pasagjerë (diesel)	30.42	30.42	30.42
Makina për Pasagjerë (benzinë)	0.00	0.00	0.00
Kombibusë	0.18	0.16	0.15
LCV	7.97	7.87	7.45
HDT	29.14	27.31	20.50
Autobusë	6.37	5.32	3.96
Motoçikleta	0.01	0.01	0.01
Gjithsej	74.09	71.09	62.48
Ulja e emetimeve PM _{2.5} (ton PM2.5/vit)			
	Viti aktual	Viti 2024	Viti 2028
Makina për Pasagjerë (diesel)	2.264	1.290	1.099
Makina për Pasagjerë (benzinë)	0.000	0.000	0.000
Kombibusë	0.015	0.010	0.006
ALK	0.296	0.262	0.181
ARI	0.501	0.404	0.145

Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit

	Autobusë	0.181	0.088	0.037
	Motocikleta	0.000	0.000	0.000
	Gjithsej	3.258	2.054	1.468
Për sa i përket emetimeve të NO _x , masat për vitin 2024 nuk janë të mjaftueshme. Megjithatë, për emetimet e PM _{2.5} , masat për vitin 2024 dhe vitin 2028 janë me efekt të mirë.				
Kosto	Meqenëse vlerësimi i koston varet nga informacioni për çmimin e automjetit, vlerësimi për të është i pamundur tani.			
Efektshmëria e kostove	Nuk vlerësohet.			
Metoda e zbatimit	Komuna do të realizojë fushatën e vetëdijesimit të publikut për të promovuar uljen e përdorimit të automjeteve.			
Çështjet	Si të përgatitet dhe zhvillohet sistemi i zbatueshëm për uljen e përdorimit të automjeteve vetëm përmes vetëdijesimit të publikut.			

2.3. Llogaritja e uljes së emetimeve nga subjektet e Lejes Mjedisore Komunale
Përmbajtja e planit të veprimit do të zhvillohet si më poshtë.

Tabela 3. Draft Plani i Veprimit për Leje Mjedisore Komunale në Komunë

Emri	Emri i Planit të Veprimit
Pasqyra	Përmbledhja e masave, fabrikat dhe objektet e targetuara.
Skenari	Numri i fabrikave dhe objekteve të targetuara me masa. Të dhëna bazë për llogaritjen e uljes së emetimeve dhe kostove.

Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit

Ulja e emetimeve	llogaritja e uljes së emetimeve të SO ₂ , NO _x , PM ₁₀ , dhe PM _{2.5}
Kosto	Kosto të zbatimit
Efektshmëria e kostove	Kosto për ulje të emetimeve (euro/ton) për PM _{2.5} dhe/ose ndotës të tjerë
Metoda e zbatimit	Si të promovohet dhe/ose zbatohet Plani i Veprimit nga Komuna
Çështjet	Shqyrtim i planit të veprimit, përfshirë reagime nga organizata relevante dhe palë të interesit

2.4. Llogaritja për uljen e emetimeve nga ndërtesat dhe objektet komunale
Ndërtesat kanë njëfarë potenciali për kursim të energjisë nëpërmjet instalimit dhe/ose përmirësimit të materialeve izoluese.
Kjo mund të ndodhë gjatë rehabilitimit ose ndërtimit të ri të një ndërtese.

Përmbajtja e planit të veprimit do të zhvillohet si më poshtë.

Tabela 4. Plani i Veprimit për emetimet nga ndërtesat dhe objektet e komunës

Emri	Kursimi i energjisë përmes përmirësimit të termoizolimit
Pasqyra	Objektivat janë ndërtesat në pronësi të Komunës me termoizolim të dobët. Efikasiteti i izolimit të këtyre ndërtesave do të përmirësohet rreth 40% nëpërmjet instalimit ose përmirësimit të materialeve izoluese. Materialet kryesore izoluese janë muret e jashtme dhe dritaret. Murit të jashtëm do t'i shtohet izolim termik. Dritaret do të ndryshohen nga dritare me një xham në dritare me xham të dyfishtë ose dritare me xham të trefishtë.

Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit

Skenari	Numri i ndërtesave dhe objekteve të targetuara me masa. Të dhëna bazë për llogaritjen e uljes së emetimeve dhe kostove.
Ulja e emetimeve	Llogaritja e uljes së emetimeve të SO ₂ , NO _x , PM ₁₀ , dhe PM _{2.5}
Kosto	Kosto të zbatimit
Efektshmëria e kostove	Kosto për ulje të emetimeve (euro/ton) për PM _{2.5} dhe/ose ndotës të tjerë
Metoda e zbatimit	Si të promovohet dhe/ose zbatohet Plani i Veprimit nga Komuna
Çështjet	Shqyrtim i planit të veprimit, përfshirë reagime nga organizata relevante dhe palë të interesit

2.5. Llogaritja për uljen e emetimeve nga industritë e shërbimeve
Përmbajtja e planit të veprimit do të zhvillohet si më poshtë.

Tabela 5. Plani i Veprimit për emetimet nga Industritë e Shërbimeve

Emri	Emri i Planit të Veprimit
Pasqyra	Përmbledhja e masave, industrive dhe objekteve të shërbimeve të targetuara.
Skenari	Numri i industrive dhe objekteve të shërbimeve të targetuara me masa. Të dhëna bazë për llogaritjen e uljes së emetimeve dhe kostove.
Ulja e emetimeve	Llogaritja e uljes së emetimeve të SO ₂ , NO _x , PM ₁₀ , dhe PM _{2.5}
Kosto	Kosto të zbatimit
Efektshmëria e kostove	Kosto për ulje të emetimeve (euro/ton) për PM _{2.5} dhe/ose ndotës të tjerë

Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit

Metoda e zbatimit	Si të promovohet dhe/ose zbatohet Plani i Veprimit nga Komuna
Çështjet	Shqyrtim i planit të veprimit, përfshirë reagime nga organizata relevante dhe palë të interesit

2.6. Llogaritja për uljen e emetimeve nga menaxhimi i mbeturinave

Burimet e emetimeve në Sektorin e Menaxhimit të Mbeturinave janë 1) Deponimi i mbeturinave të ngurta, 2) Djegia e mbeturinave klinike, 3) Djegia e hapur e mbeturinave. Duke qenë se komunat duhet të monitorojnë zonat nën juridiksionin e tyre, emetimet nga djegia e hapur e mbeturinave mund të bëhen një nga planet e veprimit që duhet marrë në konsideratë.

Përmbajtja e planit të veprimit do të zhvillohet si më poshtë.

Tabela. 6. Plani i Veprimit për emetimet nga menaxhimi i mbeturinave

Emri	Emri i Planit të Veprimit
Pasqyra	Përmbledhja e masave, aktivitetet e targetuara të menaxhimit të mbeturinave.
Skenari	Numri i aktiviteteve të menaxhimit të mbeturinave të targetuara me masa. Të dhëna bazë për llogaritjen e uljes së emetimeve dhe kostot.
Ulja e emetimeve	Llogaritja e uljes së emetimeve të SO ₂ , NO _x , PM ₁₀ , dhe PM _{2.5}
Kosto	Kosto të zbatimit
Efektshmëria e kostove	Kosto për ulje të emetimeve (euro/ton) për PM _{2.5} dhe/ose ndotës të tjerë
Metoda e zbatimit	Si të promovohet dhe/ose zbatohet Plani i Veprimit nga Komuna
Çështjet	Shqyrtim i planit të veprimit, përfshirë reagime nga organizata relevante dhe palë të interesit

Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit

2.7. Llogaritja për uljen e emetimeve nga bujqësia

Burimet e emetimit të ndotësve të ajrit në bujqësi janë blegtorja, përdorimi i tokës dhe djegia e tokës. Emetimet nga bagëtia varen nga numri i bagëtive dhe lloji i menaxhimit të plehut organik. Ministria e Bujqësisë ka përgjegjësi për këto gjëra, kështu që plani lokal i veprimit nuk duhet t'i marrë parasysh ato. Nivelet e emetimeve nga toka bujqësore varen nga sipërfaqja e tokës së përdorur dhe sasia e plehrave. Këto janë gjithashtu përgjegjësi e Ministrisë së Bujqësisë, kështu që plani lokal i veprimit nuk duhet t'i marrë parasysh.

Megjithatë, duke qenë komunat duhet të monitorojnë zonat nën juridiksionin e tyre, emetimet nga djegia e mbeturinave bujqësore në terren mund të bëhen një nga planet e veprimit që duhet marrë në konsideratë. Përmbytja e planit të veprimit do të zhvillohet si më poshtë.

Tabela 7. Plani i Veprimit për veprimtaritë bujqësore në Komunë

Emri	Emri i Planit të Veprimit
Pasqyra	Përmbledhja e masave, aktivitetet e targetuara bujqësore.
Skenari	Numri i aktiviteteve bujqësore të targetuara me masa. Të dhëna bazë për llogaritjen e uljes së emetimeve dhe kostot.
Ulja e emetimeve	Llogaritja e uljes së emetimeve të SO ₂ , NO _x , PM ₁₀ , dhe PM _{2.5}
Kosto	Kosto të zbatimit
Efektshmëria e kostove	Kosto për ulje të emetimeve (euro/ton) për PM _{2.5} dhe/ose ndotës të tjerë
Metoda e zbatimit	Si të promovohet dhe/ose zbatohet Plani i Veprimit nga Komuna
Çështjet	Shqyrtim i planit të veprimit, përfshirë reagime nga organizata relevante dhe palë të interesit

Plani Lokal i Veprimt për Cilësi të Ajrit

Drejtor i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik dhe Integrit


Nebojša Milovanović

